

P.nr. 17/17

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, në trupin gjykues të përbërë prej gjyqtarës Raima Elezi, si kryetare dhe gjyqtareve Vjollca Buzhala dhe Luan Berisha, si anetarë, me sekretaren juridike Ardijana Reshani, në lëndën penale kundër të akuzuarve R. Th. nga fshati C., Komuna e Prizrenit, R. S., nga fshati S. Komuna e Suharekës, A. M. nga fshati G. Komuna e Prizrenit dhe D. B. nga Prizreni, për shkak të veprës penale të grabitjes nga neni 329 par. 3 e lidhur me par. 1 të KP-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.246/2016 të datës 16.02.2017, pas mbajtjes së seancës kryesore publike në praninë e Prokurorit të Shtetit në Prizren Genc Nixha, të akuzuarit dhe mbrojtësve të tyre av. A. H., av.H. K., av.M. Q. dhe av.Z. K., të gjithë nga Prizreni, me datë 30.03.2018, morri dhe shpalli këtë

AKTGJYKIM**Te akuzuarit**

R. TH., me nofken ..., nga i ati A. dhe e ëma S. e lindur D., i lindur me datë *data e lindjes...*, në fshatin C. Komuna e Prizrenit, ku edhe tani jeton, i martuar, baba i katër fëmijëve, me profesion hotelier, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i denuar për veprat penale posedim i armës dhe rrahje, në paraburgim prej datës 06.10.2016.

R. S., nga i ati H. dhe ëma Sh., e lindur B., i lindur me datën *data e lindjes...* në fshatin S. Komuna e Suharekes, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, i divorcuar, babai i dy fëmijëve, punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, në paraburgim prej datës 13.10.2016.

A. M., nga i ati P., dhe ëma M., e lindur P., i lindur me datën *data e lindjes...* në fshatin G., Komuna e Prizrenit, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, beqar, punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, më heret i denuar për veprat penale vjedhje, në paraburgim prej datës 20.10.2016.

D. B., me nofken ... nga i ati A., dhe ëma F., i lindur me datën *data e lindjes...* në Prizren, ku edhe tani jeton te tranziti i ri, ka të kryer shkollën fillore, beqar, punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më heret i denuar për veprat penale të vjedhjes, në paraburgim prej datës 25.01.2017.

JANE FAJTORË

sepse me date 06.10.2016 rreth orës 02:30 minuta, në rrugën ... në Prizren, duke vepruar si anetarë të grupit të maskuar dhe të armatosur perdorin forcën apo kanosjen

serioze për të sulmuar jeten apo trupin e personit tjetër, përvetësojnë pasurinë e luajtshme të personit të tillë me qëllim që vetes të sjellin dobi pasurore të kunderligjshme, në atë mënyrë që hyjnë në shtëpinë e të dëmtuarit D. H. dhe me kërcënim të armës së zjarrit të cilën e ka pasur R. Th., një thike dhe një kaçavide të cilat i kanë pas të akuzuarit e tjerë, duke përdorur dhunë fizike ndaj tij dhe gruas K. H., të cilëve u shkaktojnë lëndime të lehta trupore, e detyrojnë të dëmtuarin D. H. të hap kasafortën në të cilën ndodheshin para në vlerë prej 18.000 euro, si dhe një sasi e konsiderueshme të arit, përafërsisht 2 kg, në vlerë prej rreth 40.000 – 50.000 euro, të cilat i kanë qitur në një çarçaf të cilin e ka marrë – bartë R. Th. dhe me shpejtësi janë larguar në drejtim të qendrës “A. 2” ku ka qenë i parkuar automjeti i të pandehurit R. S., i markës “Renault Twingo” duke shkuar në drejtim të panjohur dhe janë shpërndarë nëpër shtëpitë e tyre, ndërsa çarçafin me para dhe sendet e floririt i ka marrë i akuzuari R. Th. dhe i ka dërguar në shtëpinë e tij në fshatin C., me atë rast të akuzuarve D. B. dhe A. M. ua jep secilit shumën prej 1000 euro, e në ndërkohë në shtëpinë e të dëmtuarit ka arritur policia si dhe njësi të emergjencës të cilit me pas i kanë shoqëruar te dëmtuarit në spital për trajtim mjekësor.

- me këtë kanë kryer veprën penale të grabitjes nga neni 329 par. 3 lidhur me par.1 të KP-së.

Gjykata në bazë të nenit 7, 8, 9, 10, 21, 41, 42, 43, 44, 45, 73, 74, 76, 82 dhe neneve të përmendura më lart të KP, i

GJYKON

-të akuzuarin R. Th., me denim me burg në kohë zgjatje prej 9 (nëntë) vite, në të cilën denim llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim për datës 06.10.2016;

-të akuzuarin R. S., me denim me burg në kohë zgjatje prej 9 (nëntë) vite, në të cilën denim llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim për datës 13.10.2016;

-të akuzuarin A. M., me denim me burg në kohë zgjatje prej 9 (nëntë) vite, në të cilën denim llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim për datës 20.10.2016;

-të akuzuarin D. B., me denim me burg në kohë zgjatje prej 9 (nëntë) vite, në të cilën denim llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim për datës 25.01.2016.

Ndaj të akuzuarve vazhdohet paraburgimi derim më plotëfuqshmërin e këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit D. H. dhe K. H. për realizimin e kërkesës pronësore juridike udhëzohen në kontesin e rregullt civil.

Prej të akuzuarit R. Th. konfiskohet automjeti i markës “Fiat Punto”, me ngjyrë të bardhë, me targat të regjistrimit *numri i targës...*, dy banknota prej 500 € me nr. serik N 34055102703 dhe N 12045545503, një banknotë prej 100 euro me nr serik X 07128402626, katër bankënota prej 50 euro me nr serik X 90139729277, X 87689766323, X 13901792933, S 51108808498, 14 bankënota prej 20 euro, me nr serik NA 63147335233, SE 9066025972, XA 056989357, UD 6011438805, S 40090230628, XA 1579338207, NA 3718591444, RA 344204778, XA 4223852217, WA 1973155222, LL 33954339807, X 38999624033, H 55242843426, XA 3436414812, tri bankënota prej 10 euro, me nr serik XA 3500078002,

EB 4463119899 dhe PA 3741748739 dhe një bankënotë prej 100 US me nr serik AF 66154395B, prej të akuzuarit R. S. konfiskohet automjeti i markës “ Renault Twingo”, me ngjyrë të kaltërt , me targa të regjistrimit *numri i targës...*, prej të akuzuarit A. M. konfiskohen një kartëmonedhë në vlerë prej 500 euro, me nr serik N 22066230585, një kartë monedhë prej 20euro me nr serik RB 042594033 dhe një kartëmonedhë në vlerë prej 10 euro , me nr serik XA 2182951038 , si mjete të cilët janë përdorur në kryrjen e veprës penale dhe sendet të cilat janë rezultat i kryerjes së veprës penale.

Obligohen të akuzuarit R. Th., R. S., A. M. dhe D. B. që solidarisht të paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale në emër të ekspertizës mjeko ligjore, sipas llogarisë së gjykatës, e në emër të paushalit gjyqësor secili shumën nga 1000 € (njëmijë euro) dhe secili prej tyre nga 50 € në emër të kompenzimit për viktimat e krimit, të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Renda ka ngritur aktakuzën PP/L.nr.246/2016, më 16.02.2017, kundër të akuzuarve R. Th. nga fshati C. KK Prizren, R. S. nga fshati S. Komuna e Suharekës, A. M. nga fshati G. Komuna e Prizrenit dhe D. B. nga Prizreni, për shkak të veprës penale të grabitjes nga neni 329 par. 3 e lidhur me par. 1 lidhur me nenin 31 të KP-së.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në bazë të provave të administruara edhe atë dëgjimit të dëshmitarëve si dhe provave materiale është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve formohen elementet e veprës penale për të cilën akuzohen. Gjendja faktike pjesërisht vërtetohet edhe në bazë të deklaratave të të akuzuarve D. B., R. S. dhe A. M., në bazë të listingut të telefonatave, hartografisë, listës së dëshmimeve të konfiskuara nga të akuzuarit, vërtetimit mbi sekuestrimin e sendeve, ekspertizës mjeko ligjor dhe me shikimin e video inçizimeve. I akuzuari D. B. ka spjeguar rastin duke theksuar se 5-6 ditë pasi është liruar nga burgu është takuar me të akuzuarin R. Th. dhe të akuzuarit e tjerë dhe pasi ata kanë qenë me automjet ai është ulur në automjetin e R. Th., kanë bërë xhiro nëpër qytet dhe kanë shkuar në restorantin “S. P.”, pas një kohe sërish kanë shëtitur nëpër qytet dhe janë marrë vesh që të hyjnë në një shtëpi në afërsi dhe para se me hy në atë shtëpi, ka vërejtur se R. Th. ka pas një revole, ndërsa te R. S. dhe A. M. nuk ka pa sekanë pasur diçka. Kur kanë dal prej shtëpisë R. Th. ka pasur në duar një çarçaf të bardhë dhe më vonë ka kuptuar se aty ka pas para dhe ari, së bashku janë larguar te parkingu “A. 2” ku ka qenë i parkuar automjeti dhe kanë shkuar në drejtim të kishës katolike, ku ka shpërthyer goma e automjetit, me ç rast kanë lënë automjetin, kanë dalë jasht dhe R. Th. ia ka dhënë 100 euro. I akuzuari R. S. duke spjeguar rastin ka deklaruar se ai ka bërë roje derisa të tre të akuzuarit kanë hyrë brenda në shtëpi, ndërsa nga deklarata e të akuzuarit A. M. se i njëjti është takuar në qytet rreth orës 19:00 dhe së bashku kanë shkuar tek pompa e benzinës “S. P.”, ku më pas janë takuar me të akuzuarin R. Th.. Nga deklarata e të akuzuarve të dhënë në shqyrtim kryesor, të cilat dallohen diametralisht nga deklaratat e para, kuptohet se ata janë sinkronizuar nga fakti se gjatë qëndrimit në paraburgim kanë pasur raste të takohen dhe të sinkronizojnë detajet, duke përgaditur verzionet në mënyrë që i akuzuari D. B. përmes një paraburgosuri ka dërguar një letër për të akuzuarin R. S., duke e mësuar në çfarë mënyre duhet të tregon rastin por në bazë të njoftimit të siguruar nga Qendra e Paraburgimit në Prizren, vërtetohet se në periudhën për të cilën pretendon i akuzuari nuk është bërë asnjë transfer personit me emër V. prej Burgut të Dubravës në QP në Prizren. Nga listingu,

hartografia dhe deklarata e zyrtarit policor lidhur me rastin vërtetohet se gjatë ditës të akuzuarit kanë kontaktuar përmes telefonatave, vëndndodhja e tyre natën kritike para kryerjes së veprës penale dhe se në kohën e kryerjes kanë qenë afër vendit të ngjarjes. Po ashtu nga video incizimet, deklarata e dëshmitarit N. M. i cili atë natë ka punuar si rojtar në Qendrën tregtare “A. 2 “ vërtetohet se se para orës 04:00 të mëngjezit ky dëshmiar ka vërejtur që automjeti në fjalë ka lëvizur dhe ka dalë nga oborri, e nga incizimi vërtetohet se këtu të akuzuarit kanë hyrë në automjet dhe janë larguar nga oborri i qendrës duke shkuar në drejtim të kishës katolike. Në bazë të foto dokumentacionit vërtetohet se dy automjete kanë qenë në përdorim nga ana e të akuzuarve, një në pronësin e të akuzuarit R. Th. e tjetra e të akuzuarit R. S.. Nga deklaratat e të dëmtuarëve dhe ekspertiza mjeko ligjore vërtetohet se me rastin e kryerjes së veprës penale ndaj të dëmtuarëve është përdorur dhuna si dhe mjetet edhe atë thika apo kaçavida dhe kanë pësuar lëndime të lehra trupore dhe shqetësime psikike. Nga të gjitha këto konsideron se në veprimet e të akuzuarve formohen elementet e veprës penale me të cilën ngarkohen, andaj propozon që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata duhet të marrë parasysh faktin se të akuzuarit nuk kanë pranuar fajësinë por kanë tentuar të fshehin përgjegjësinë e tyre, në asnjë mënyrë nuk kanë shprehur keqardhje për kryerjen e veprës penale, janë persona recidivist, A. M. dhe R. S. të cilit kanë deklaruar se janë takuar gjatë vuajtjes së dënimit e po ashtu edhe i akuzuari R. Th., ndërsa për të akuzuarin D. B., i njëjti është i njohur si kryes i shumë veprave penale, andaj nuk mund të propozon ndonjë rrethanë lehtësuese dhe konsideron se të njëjtit duhet të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit.

Përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarve avokat E. R. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në bazë të provave të administruara është vërtetuar gjendja faktike sikurse në aktakuzë sidomos nga deklarata e të akuzuarit D. B. i cili në procedurën paraprake në tërësi ka përshkruar mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe deklarata e tij përputhet dhe është në harmoni me ngjarjen të cilën e kanë përshkruar të dëmtuarit D. dhe K. H. si dhe dokumentohet në bazë të video incizimeve, ku shihet se të akuzuarit një kohë kanë qëndruar në restorantin e pompës së benzinës “S. p.” dhe pas grabitjes janë kthyer në parkingun “A. 2 “, ku e kanë pasur të parkuar automjetin dhe janë larguar. Të akuzuarit në mbrojtjen e vet, të ballafaquar me prova materiale nuk kanë qenë në gjendje të japin arsye bindëse se si janë takuar dhe janë gjetur në vendin e ngjarjes, në kohën e kryerjes së veprës, nuk kanë mundur t’i harmonizojnë mbrojtjet e tyre, kështu që ato kanë qenë në kundërshtim lidhur me faktet dhe rrethanat që tregojnë se janë kryesit të veprës penale për të cilën ngarkohen. Po ashtu edhe i akuzuari R. S. në mbrojtjen e vet ka konfirmuar pretendimet e akuzës me disa modifikime, të cilat po ashtu në mënyrë të pamohueshme dëshmojnë se të akuzuarit kanë kryer veprën penale dhe mbrojtjes së tyre, në pjesën tjetër gjykata nuk duhet tu falë besimin, sepse kanë për qëllim të ikin nga përgjegjësia penale. Propozon që të akuzuarit të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit dhe shton se i bashkangjitet fjalës përfundimtare të Prokurorit të Shtetit. Në emër të palës së dëmtuar parashtron kërkesën pronësore juridike për dëm material de shumën prej 68.000 € (gjashtëdhjetetë mijë euro), ndërsa për dëmin jo material do të deklarohet gjatë procedurës së rregullt civil.

Mbrojtësi i të akuzuarit R. Th., avokat A. H., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se aktakuza e Prokurorisë nuk mbështetet në prova dhe e gjithë aktakuza mbështetet në dyshimin se me datë 05.10.2016, rreth orës 22:30 minuta, në parkingun e “A. 2 “ paskan vërejtur dy vetura të ngjajshme me veturat që i posedon i mbrojturi i tij dhe i akuzuari R. S., pra vetura “Renault Twingo “ dhe “Fiat Punto” . Nga ana e Prokurorisë janë propozuar një mori provash si provat personale, deklaratat e dëshmitarëve dhe provat materiale, por me asnjë provë nuk është vërtetuar pretendimi i prokurorisë dhënë në aktakuzë. Nga deklarata e

dëshmitarëve, të dëmtuarëve K. H. dhe D. H., në procedurën paraprake dhe gjatë shqyrtimit kryesor vërehen kundërshtime, kundërhënie, mohime dhe supozime. Andaj në këto rrethana gjykata duhet të zbatojë nenin 3 par 2 të KPP. Dëshmitari A. B., gjatë shqyrtimit kryesor ka dëshmuar në rrethana të numrave kontaktuese për datat 05, 06, 07. 10. 2016 dhe sa i përket hartografisë, por gjatë leximit të raporteve nuk ka qenë i saktë sepse nuk ka lexuar plotësisht orën, minutat dhe sekondat, andaj kjo deklaratë nuk është e plotë dhe e saktë dhe nuk mund të ketë vlerën provuese. Janë dëgjuar dëshmitarët I. E. dhe N. M. mirëpo konsideron se këto dy deklaratat janë të pa pranueshme në kuptim të së vërtetës së përmbajtes, andaj gjykata nuk duhet të falë besimin. Sa i përket provave materiale, vërtetimin mbi marrjen e sendeve për A. M. nuk është kontestuese sepse sendet janë marrë por gjatë seancës prokurori ka bërë përmirësimin e gabimit teknikë të provës lista e dëshmimeve për R. S.. Prova lista e dëshmimeve e datës 13.10.2016, tregon se me rastin e bastisjes në fshatin S. gjësendet nuk janë marrë nga R.. S. sepse ai nuk është pronar i shumë sendeve të cilat janë marrë. Nga dy ekzaminime edhe pse nuk është gjetur asgjë e ndaluar, mbrojtja konsideron se në rastin konkret ka shkelje procedurale ngase ka munguar urdhëri për kontroll, e që pastaj Prokuroria plotëson propozimin lidhur me raportin e ekzaminimit të veturës dhe propozon që raporti duhet të ketë titull shiqimi në fotodokumentacion e që ka të bëjë me automjetin “Fiat Punto” me targa *numri i targës....* Po ashtu konsideron se mungojnë faktet (sqarime të nevojshme) lidhur me listingun hartografi, sepse ekzistojnë mungesa në mes numrave thirrëse dhe të pranuesit, ku ishte pa numër, kishte thirrje të cilat ishin të regjistruara në të njëjtën kohë që një numër të ketë thirrur dy persona. Është e pa ndriçuar fakti se si paska komunikuar R. Th. me datën 06.10.2016 në ora 18:10:08, nga numri *numri i telefonit...* me numrin *numri i telefonit...* dhe një kontakt tjetër kur i mbrojturi i tij ka qenë në ndalim të datës 06.10.2016 nga ora 12:25 minuta kur edhe ka dhënë deklaratën në polici. Nga raporti i vendit të ngjarjes nuk vërtetohet se është gjetur ndonjë gjurmë e cila do të ndërlidhte të akuzuarin me vendin e ngjarjes mbi gjurmët e gishtërinjëve dhe është siguruar raporti plotësues në lidhje me drejtimin e largimit të personave të dyshuar dhe kanë biseduar me fqinun S. S. ku nga automjetet e tija dhe në kulmin e teracës janë marrë gjurmët të gishtërinjëve të dorës dhe të mbathjeve dhe sipas krahasimit me të gjurmët e të pandehurve, është konstatuar se nuk kanë qenë të tyre. Ndër të tjera në raport është përshkruar vendi ku ndodhet shtëpia e të dëmtuarit D. H. dhe e dëshmitarit A. H., se hyrja në anën e majtë nga rruga i përkiste të dëmtuarit D. H. ndërsa në anën e djathtë nga rruga vëllaut të tij, pra ky raport lenë të kuptohet se në mes të këtyre dy shtëpive ekziston rruga, atëherë ky fakt ndërlidhet me atë rëfimin e famshëm të dëshmitarit se në ora 03:00 ka kaluar nga ballkoni i shtëpisë së tij në ballkonin e shtëpisë së axhës D. dhe atë në katin e tretë, pastaj ceket se çelësi ka qenë i vendosur në derën e hyrjes nga prapa, se është këputur gjysma e cilindrit nga pjesa e jashtme dhe është gjetur në oborr tek çeshmja, por pasi mungon mendimi i ekspertit se a është e mundur të bëhet hapja kur dera ka qenë e mbyllur nga brenda dhe çelësi ka qenë në derë, në cilindër edhe në raste kur këputet gjysma e cilindrit nga jashtë kurse gjysma tjetër së bashku me çelësin mbetet në derë dhe të bëhet hapja e derës pa dëmtime anësore. Madje gjatë dhëniës së deklaratës dëshmitarja K. H. ka deklaruar se para se me fjet i ka mbyllur të gjitha dyert, duke filluar nga dera e hyrjes së oborrit dhe shtëpisë dhe të dhomave të tjera përveç dhomës së gjumit ku kanë fjetur. Andaj parashtrahet pyetja si janë hapur të gjitha dyert e dhomave pa asnjë dëmtim pasi që nuk ka demolime në dyer. Sa i përket raportit informues të datës 14.12.2016 edhe atë raporti i ekspertimit lidhur me ekzaminimin e dy telefonave të mbrojturit të tij, ku janë nxjerrur SMS të pranuar apo të dërguara, incizime audio apo video të ruajtura, thirrjet e realizuara dhe të dështuara, thirrjet e pranuar nuk tregojnë se i mbrojturi i tij është i implikuar në rastin, përveç që raporti informues i datës 06.10.2016 në ora 05:44, se i mbrojturi i tij përmes “facebook” ka kontaktuar një femër H. Ç., të cilës ndër tjera i shkruan “qoma numrin e K. të ia qojë ndonjë lekë”, pra kjo është e vetmja e gjetur në raport. Nga rezultatet e krahasimit

dhe qartësimi nuk është arritur të identifikohen veturat dhe nuk është konstatuar se fjala është për vetura të njëjta dhe raporti i datës 29.11.2016 lidhur me ekzaminimin e personave nuk është i plotë dhe a janë identifikuar plotësisht për shkak të rezolucionit të dobët të kamerave. Me shiqimin e CD –ve 1, 2 dhe 3 nuk mund të identifikohet se për cilin restorant bëhet fjalë dhe nuk janë identifikuar personat e shfaqur në kamerë e as automjetet e cekura në aktakuzë. Nga foto dokumentacioni i cili është i përbërë nga 140 fotografi të shtëpisë së të dëmtuarit si pamja nga jashtë, oborri dhe brenda shihet qartë se ekzistojnë fotografi të cilat nuk përputhen në mes vete dhe lejojnë hapësirë për interpretime të ndryshme. I mbrojturi i tij ka dhënë katër deklaratat dhe ka spjeguar se sa i përket natës kritike të pandehurit janë takuar në lokalin e tij në fshatin K. rreth orës 17:00 – 18:00, kanë biseduar për narkotikë dhe janë marrë vesh që të sigurohet narkotiku për datën 06.10.2016, se aty kanë qëndruar deri në ora 22:00 -23:00 pastaj i mbrojturi i tij me veturën “Fiat punto” i ka dërguar deri te “H. P.” që gjendet në fillim të rrugës transite, përball objektit të “Liburnisë”, aty kanë zbritur A. dhe D. për të shkuar në shtëpi ndërsa ai dhe R. S. janë kthyer përsëri te restoranti “A. C.” në K. ku i akuzuari R. S. ka marrë veturën e vetë dhe është nisur për në shtëpi, ndërsa i mbrojturi i tij ka shkuar në lokalin e R. Zh., ka luajtur letra dhe pas një kohe është dëgjuar me një femër të tij nga S. të cilën e ka marrë dhe ka shkuar në F. për tu furnizuar me narkotikë. Gjatë kthimit në S. pasi që femra ka zbritur nga vetura, ai ka shkuar në restorantin në fshatin K. dhe ka spjeguar po ashtu edhe qysh i njehtë bashkakuzuarit. Të akuzuarit R. S. dhe D. B. në shqyrtimin kryesor kanë mohuar deklaratat e dhëna në polici dhe në prokurori dhe D. B. ka treguar formën se si ka ndikuar tek R. S. dhe për çfarë arsye ka dhënë deklaratën e parë. Andaj konsideron se aktakuza e prokurorisë si në aspektin sasior dhe cilësor të provave është ndërtuar në deklaratat e bashkakuzuarve D. B. dhe R. S. edhe pse procedura penale parasheh se deklaratat e të bashkakuzuarit nuk mund të përdoret si provë. Në bazë të provave të administruara vërehet shumë mospëputhje në mes tyre, ka paqartësi, ka supozime në dëshmi, kundërtënie në mes dëshmimeve, ka mëdyshje në vërtetimin e fakteve relevante, ka kundërshtime, provat nuk kanë vlerë të plotë provuese andaj propozon që në mungesë të provave i mbrojturi i tij të shpallet i pafajshëm për veprën penale për të cilën akuzohet dhe gjykata të merr aktgjykimin lirues konformë nenit 364 par. 1 pik. 1.3 të KPP-së.

I akuzuari R. Th. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohet me fjalët e mbrojturit të tij duke shtuar se prokurori i shtetit në fjalën e tij ka përmendur fjalën recidivist por ai asnjëherë nuk ka kryer ndonjë veprë penale të vjedhjes përveç që ka raste të rahjes, armabajtje pa leje dhe lidhur me substancë narkotike.

Mbrojtësi i të akuzuarit R. S. av. K. K. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në bazë të provave të administruara mendon se nuk është provuar se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale të përshkruar në dispozitivin e aktakuzës dhe nuk rezulton se më 06.10.2016, rreth orës 02:30 minuta, të ketë qenë i mbrojturi i tij si anëtar i ndonjë grupi të maskuar dhe i armatosur për grabitje, i cili rast ka ndodhur në shtëpinë e të dëmtuarit D. H.. Është vërtetuar se i mbrojturi i tij dhe të tjerët janë njohur edhe më parë me të akuzuarin R. Th., mirëpo njohja e tyre nuk është përcjellë me shoqërim ndërmjet tyre por vetëm kur ka vizituar restorantin e të akuzuarit R. Th. me qëllim që të kërkon sigurimin e substancës narkotike marihuanën për përdorimin personal. I mbrojturi i tij të akuzuarin A. M. një herë rastësisht e ka taktuar ndërsa të akuzuarin D. B. më herët nuk e ka njohur dhe natën kritike rastësisht e ka taktuar në restorantin e R. Th. duke qëndruar një kohë në një tavolinë. Këto fakte dhe relacioneve ndërmjet tyre konfirmohen edhe me deklaratat e të akuzuarve R. Th., A. M. dhe D. B.. Me asnjë provë nuk është vërtetuar se i dëmtuari D. H. të ketë pasur sasinë e arit dhe parave siç është cekur në dispozitivin e aktakuzës dhe mos vërtetimi i këti fakti aktakuzën e

bënë juridikisht të pambështetëshme. Me asnjë provë materiale si marrja e mostrave të duarve dhe gishtinjtëve, nuk vërtetohet se i mbrojturi i tij ka qenë involvuar në kryerjen e veprës penale. Në bazë të raporteve mjekësore të të dëmtuarëve D. dhe K. H. dhe foto dokumentacionit nuk vërtetohet, po në fakt mohohet se në çfarëdo çoftë formë dhe mënyrë i mbrojturi i tij ka qenë involvuar në rastin e grabitjes dhe këtë fakt nuk e vërtetojnë as deklaratat e dëshmitarëve. Andaj kërkon që gjykata në bazë të nenit 364 par. 1 nënpar. 1.3 të KPP -së të marrë aktgjykim lirues.

I akuzuari R. S. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohet me fjalët e mbrojturit të tij duke shtuar se nuk është kategori e atyre njerëzve siç akuzohet me aktakuzë.

Mbrojtësi i të akuzuari A. M. av. M. Q. në falën përfundimtare ka deklaruar se me asnjë provë të administruar nuk është vërtetuar aktakuza e prokurorisë i cili dispozitiv është i sajuar mbi rëfimet e të dëmtuarve të cilat nuk mbështeten në asnjë provë konkrete. I mbrojturi i tij nga deklaratat e dhënë në polici ka mohuar kryerjen e veprës penale, ka sqaruar se ditën kritike është takuar me të akuzuarit e tjerë por gjatë kohës sa ka qëndruar me ta nuk kanë kryer asnjë nga veprimet e përshkruara në aktakuzë. Në bazë të deklaratave të dëmtuarve vërtetohet se natën kritike me datën 06.10.2016 personat e maskuar, me forcë kanë hyrë në shtëpinë e tyre të armatosur dhe duke përdorur dhunën dhe kërcnime kanë hapur kasafortën dhe nga aty kanë marrë arin dhe të hollat e cekura në aktakuzë, por asnjërin nga këta nuk kanë qenë në gjendje ta identifikojnë. Në këto rrethana dëshmia e tyre vërteton pretendimin e mbrojtjes se të akuzuarit nuk janë personat që kanë kryer këtë veprë. Po ashtu nuk mund të vërtetohet fakti se si kanë mundur ta dinë të akuzuarit për ekzistimin e kasafortës kur asnjëherë nuk kanë qenë në shtëpinë e të dëmtuarve, nuk kanë ditur kush ndodhet në atë ashtëpi etj. faktet që vërtetojnë se veprën mund të ketë kryer vetëm një i afërm i cili i njëj të dëmtuarit, por deklaratat e të dëmtuarve në mënyrë absolute përjashtojnë mundësin që të akuzuarit kanë qenë personat të cilët kanë kryer veprën. Dëshmitari A. B., polic zyrtar ka dëshmuar në rrethanat lidhur me sigurimin e provave që kanë të bëjnë me hyrje dalje të bisedave telefonikë të numrave “Vala” dhe “Ipko”, që kanë poseduar të akuzuarit në atë kohë. Ky dëshmitar përveç informacionit për biseda nuk ka dëshmuar asnjë fakt relevant pasi që të akuzuarit asnjëherë nuk e kanë mohuar se njihen në mes vete, se komunikojnë në telefon dhe se kjo nuk paraqet asnjë provë në drejtim të vërtetimit të ndonjë fakti relevant lidhur me veprimet inkriminuese. Dëshmitari I. E. përveç tjerash ka dëshmuar se në fillim të vitit 2017, ka transportuar disa persona me automjetin e tij si taksist dhe ka mundësi se ka qenë kljent edhe A. M. dhe të akuzuarit e tjerë, por deklarata e tij nuk ka asnjë randësi as peshë lidhur me të mbrojturin e tij. Dëshmitari N. M. jo vetëm që nuk i ka identifikuar të akuzuarit por ai nuk ka treguar ndonjë fakt me rëndësi lidhur me rrethanat për natën kritike duke dëshmuar se ka hapur zinxhoret me të cilët mbyllet hyrja dhe nga parkingu ka dalë një automjet, i cili fakt shihet edhe në filmimet e kamerave, por se kush ka vozitur automjetin dhe kush ka qenë në automjet nuk vërtetohet, andaj dëshmia e dëshmitarit është e parëndësishme. Sa i përket provave materiale konsideron se nuk kanë peshë për shumë arsye sepse mungojnë kushtet për sigurimin e provave dhe nuk provojnë asnjë fakt që ka të bëjë me objektin e aktakuzës siç janë lista e dëshmimeve, vërtetimi mbi marrjen e përkohëshme të sendeve etj. Nga videoincizimi CD-së nga lokali “S. P.” ku shihen disa persona, nuk vërtetohet se a janë të akuzuarit apo personat tjerë por edhe sikur të ishin të akuzuarit ky fakt nuk i ndërlidhë me veprën penale. Kërkon nga trupi gjykues që në bazë të këto rrethanave i mbrojturit i tij të lirohet nga aktakuza.

I akuzuari A. M. në fjalën përfundimtare ka pranuar fjalën e mbrojtësit të tij duke shtuar se gjatë tërë procedurës prej prokurorit ka kërkuar mbështetje për të zbuluar të

vërtetën, pavarësisht se kush është fajtor, ka kërkuar rekorder (incizim) për të hyrë në Qendrën e paraburgimit në Prizren, por prokurori e ka refuzuar, është plotësisht i pafajshëm.

Mbrojtësi i të akuzuarit D. B. av. Z. K. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se është e vërtetë se i mbrojturi i tij natën kritike fare nuk ka qenë tek shtëpia e të dëmtuarve por ka qenë në shtëpinë e vet pas kthimit nga Suhareka. Nga përshkrimi i aktakuzës nuk vërtetohen veprimet e të akuzuarit D. B. . Nga dëshmitë e të dëmtuarve D. H. dhe K. H. si dhe dëshmitarit A. H. nuk vërtetohet se natën kritike i mbrojturi i tij dhe të akuzuarit e tjerë kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen, ky fakt nuk vërtetohet as me dëshminë e dëshmitarëve I. E. dhe N. M.. Nga raporti i ekzaminimit të veturës “Fiat Punto” pronë e të akuzuarit R. Th. si dhe dëshmitë e gjetura në automjetet nuk kanë lidhje me rastin konkret sepse asnjë send nuk i takon të dëmtuarit. Nga listingu i hyrje – daljeve për numrat e telefonave nuk vërtetohet që numri i telefonit i cili i takon të akuzuarit D. B., me datën 05-06.10.2016 ka pasur ndonjë kontakt me numrat e telefonave të të akuzuarëve të tjerë. Fotografitë e mobiljeve të demoluara, gjërave të shpëndara nëpër dhoma, dyerve të thyera, dryve të dëmtuara tregojnë se aty ka ndodhur diçka, por nuk dëshmojnë faktin se kush i ka kryer këto veprime dhe nga ekspertiza lidhur me gjurmët e gishtrinjëve vërtetohet se i nuk i takojnë të akuzuarit D. B. apo të akuzuarve të tjerë, nga shikimi i CD-eve 1,2 dhe 3 në të cilat gjendjen video incizimet e kamerave të sigurisë të marra nga “A. 2” nuk vërtetohet se cilët persona kanë qenë aty në parkingë, sa persona kanë hyrë në veturë, çfarë ngjyre ka qenë vetura, cili model dhe cilat kanë qenë targat e regjistrimit, nga fotografitë e nxjerra nga video incizimet te restoranti “S. P.” për shkak të kualitetit të dobët të incizimit nuk mund të identifikohet prezent ka qenë i mbrojturi i tij. Nga krahasimi i fotografive të veturave nga video incizimi të cilët janë fotografuar para rastit, me fotografitë e veturave të llojit “Renaut Twingo” dhe “Fiat Punto” të cilat janë fotografuar pas rastit, nuk vërtetohet se janë vetura të njëjta. Deklaratat e të mbrojturit të tij të dhëna në procedurën paraprake, në polici dhe në prokurori në asnjë mënyrë nuk mund të merren si të pranushme pasi që i mbrojturi i tij ka qenë nën ndikimin e substancës narkotike të llojit kokain dhe nga deklarata e të akuzuarve të tjerë është vërtetuar se i mbrojturi i tij është përdorues i kësaj substance, po ashtu duke marrë parasysh aftësinë e tij intelektuale dhe volutive dhe gjendjen e tij psikike sepse nuk ka qenë në gjendje të kuptoj natyrën, rëndësinë dhe pasojat e deklaratës së tij, andaj konsideron që gjykata duhet marrë parasysh deklaratën e dhënë në shqyrtimin kryesor. Propozon që i mbrojturi i tij të lirohet nga aktakuza në mungesë të provave.

I akuzuari D. B. në fjalën përfundimtare ka shtuar se gjykata duhet të pranojë deklaratën e tij e dhënë në shqyrtimin kryesor sepse deklarata e dhënë në polici është një montazhë të cilën e ka dhanë nën kërcënime me shumë vepra tjera penale, se nëse nuk deklarohet kështu dhe nuk e pranon këtë vepër do të paraqesin të gjitha veprat e tjera, e njëjta gjë ka ndodhur edhe me rastin e dhënies e deklaratës pranë prokurorisë. Konsideron se në provat të cilat janë propozuar edhe atë dëshminë e dëshmitarit A. H. dhe provat materiale nuk përputhet koha sepse në incizim është koha 03:53minuta , në hartografi thotë se deri në ora 03:00 personat kanë qenë afër vendit të ngjarjes e pastaj janë larguar, andaj konsideron se këto fakte nuk janë sqaruar e as vërtetuar.

I akuzuari R. Th. në mbrojtjen e vet, në procedurën paraprake ka theksuar se me datën 05.10.2016, ka qenë në lokalit e R. Zh. te tregu i gjelbër, në lagjen O., në shoqëri me disa persona të cilët nuk dëshiron t'i përmend por pronari i lokalit sigurisht i njeh ata. Aty ka luajtur me letra deri në ora 23:30 minuta dhe pasi ka kontaktuar me të dashurën e tij nga Suhareka, me automjetin “Fiat Punto”, me targa të regjistrimit *numri i targës...*, i cili është në emër të pronarit nga K., prej të cilit e ka blerë 3-4 javë më herët por nuk e ka përkthyer në

emër të tij. Para se të takohej me të dashurën ka konsumuar narkotik dhe ka vazhduar konsumimin edhe me të dhe bashku kanë shkuar në Ferizaj për tu furnizuar me narkotikë. Në të kthyer janë ndalur në tre lokacione dhe kanë përdorë narkotik dhe kur kanë arritur në Suharekë, dashnorja ka zbritur nga automjeti dhe ai ka vazhduar deri në lokalin e tij "A. C." që gjendet në rrugën magjistrale Suharekë-Prizren. Në deklaratën e mëvonëshme ka theksuar se është e mundur se natën kritike ka qenë edhe në një restorant "S. P." në afërsi të spitalit me R. S., A. M. dhe D. B., ku kanë pirë kafe dhe me siguri prej këtij restoranti ka shkuar në Ferizaj, por nuk i kujtohet sepse ka qenë nën ndikimin e narkotikut. Personin R. S. e njeh që 10-15 vite, ai është dhëndër i S., A. M. e njeh si klient i rregullt i lokalit të tij "A. C.", ndërsa D. B. nuk është i sigurt që e njeh, por është e mundur që natën kritike ka qenë edhe ai në restorant, ashtu që nuk është e vërtetë se natën kritike ka qenë në grup me personat të cilët kanë kryer veprën penale të grabitjes për të cilën akuzohen.

Në shqyrtimin kryesor ka shtuar se restorani i tij "A. C." punon prej orës 17:00 deri në ora 03:00 pas mesnate, por nëse ka punë punon edhe më gjatë, pasi mbyllet restoranti shkon në shtëpi dhe flen deri në ora 15:00 – 16:00. D. B. më herët nuk e ka njohur me emër por vetëm me pseudonim "T." edhe atë përafërsisht tri vitet e fundit. Me datën 05.10.2016, diku në ora 18:00, në restorantin e tij ka ardhur R. S. i vetëm, kanë pirë kafe e më vonë kanë ardhur edhe A. dhe D. dhe kanë qëndruar deri në ora 23:00. Qëllimi i ardhjes ka qenë që prej tij të kërkojnë marihuanë dhe pasi që nuk ka poseduar i ka premtuar se do të furnizohet, të tretë kanë qenë të interesuar për blerjen e marihuanës dhe meqë janë klient të restorantit, ka dashur t'iu ndihmojë. Pasi që restorani është me muzikë të gjallë, çmimet e pijeve dhe të ushqimit janë më të larta, andaj interesimi i tij ka qenë që ata të qëndrojnë më gjatë për cek. Diku në ora 23:00, së bashku me R. S., me veturën e vet A. dhe D. kanë dërguar deri te pompa e benzinës "H.-P." përballë hidroregjionit dhe janë kthyer deri te restoranti "A. C." ku ka qenë e parkuar vetura e R. S. i cili ka marrë veturën dhe ka shkuar në drejtimin e vet e ai me veturën Fiat Punto ka shkuar në lokalin e D. Zh. tek tregu i Gj. dhe ka luajtur me letra (bixhoz), nuk e di sa koha ka qëndruar në atë vend, nga ka shkuar në Suharekë ku ka takuar të dashurën dhe bashkë kanë shkuar në Ferizaj për të marrë kokain, janë kthyer në Suharekë ku e lënë vajzën dhe ka vazhduar për në shtëpi. Nuk është e vërtetë se ka qenë në restorant "S. P." afër spitalit regjional dhe nga video incizimi në CD nuk vërtetohet se ai shihet në atë incizim natën kritike, nuk është e vërtetë as se automjeti i tij Fiat Punto ka qenë i parkuar në parkingun "A. 2", afër "S. P.". Gjatë takimeve me R. S. ka kuptuar se ai është përdorues i substancës edhe më herët ka ndodhur që ai ka kërkuar të furnizohet prej tij, i kujtohet se natën kritike në restorantin e tij R. ka përdorur pije alkoolike, por nuk i kujtohet se në çfarë gjendje ka qenë dhe a ka mundur të kontrollojë veprimet e veta. Me A. M. edhe para natës kritike, më 05.10.2016, janë takuar në restorant, e di që edhe ai është përdorues i narkotikut dhe natën kritike kur e ka dërguar A. deri tek H. – P. e din që ai ka shkuar në shtëpi dhe marrëveshja ka qenë që të takohen të nesërmen. Po ashtu e din se edhe D. e përdor substancën narkotike. Është përdorues i duhanit edhe atë "Marllboro"

I akuzuari R. S. në deklaratën e dhënë në procedurën paraprake ka theksuar se të akuzuarin A. M. e ka njohur gjatë qëndrimit në Gjermani ku janë takuar shpesh dhe kur është kthyer në Kosovë është takuar me A. një muaj para ditës kritike dhe kanë ndërruar numrat e telefonit, po ashtu edhe atë ditë kur është arrestuar është takuar me të në orët e paditës, meqë paraprakisht e ka thirrur në telefon për të pirë kafe dhe meqë ka qenë në Suharekë janë takuar dhe kanë shkuar në lokalin ... Gjatë bisedës A. e ka lutur që të dërgojë në Pejë, ka pranuar dhe me automjetin e tij "Renault Twingo" e ka dërguar dhe lënë në rrethin e parë në hyrje të qytetit dhe është kthyer në fshat në shtëpi. R. Th. e njeh më se 20 vjetësh, ai është pronari i restorantit "A. C." ku shkon kohë pas kohe, janë takuar por nuk mund të thotë se kanë pasur

ndonjë shoqëri, ka ndodhur që kanë biseduar përmesë telefonit. Sa i kujtohet për herë të fundit para se të arrestohet kanë biseduar për një femër e quajtur M. nga Shqipëria të cilën ka pasur dashnore, e cila ka punuar në restorantin e tij “A. C.”. Është e mundur se ka pasur takim me R. Th., ai përmes disa shokëve ka kërkuar t’i paguaj një cek të papaguar në emër të borxhit. Posedon veturën “Renault Twingo” me targ. të regjistrimit *numri i targës...*, e dinë që R. Th. posedon një automjetë por nuk e di çfarë marke, është automjeti i vogël me ngjyrë të bardhë. Pasi ka shikuar disa foto në polici i kanë treguar se R. Th. posedon automjetin e tipit “Fiat Punto”, mirëpo në bazë të fotografisë së veturës së tij “Renault Twingo”, edhe pse nuk shihet si duhet, ka thënë se ka mundësi të jetë i tij, sepse ka pasur një rotkapne sa i kujtohet në anën e djathtë edhe grithje në anën e majtë. Ka ndodhur që kohëve të fundit ka dhënë automjetin e vet një personit nga Shqipëria, për të cilin din se punon me bari. Nuk e di se me datën 06.10.2016, ka qenë në shoqëri me të akuzuarit R. Th. dhe A. M.. Kohë pas kohe përdor substancën narkotike.

Në deklaratën e mëvonshme ka theksuar se ditën kritike me automjetin e tij “Renault Twingo”, ka ardhur në Prizren për tu furnizuar me narkotikë- marihuanë. Nuk i kujtohet a e ka thirrë ai A. apo A. e ka thirrë këtë, por janë takuar në orët e pasditës në Prizren, janë shëtitur nëpër qytet dhe në ora 21:00, diku te rrethi në dalje të Prizrenit janë takuar me R. Th. i cili po ashtu ka qenë me automjetin e tij në shoqëri me të akuzuarin D. B.. Janë marrë vesh që të shkojnë në një restorant ku kishte muzikë, ku kanë qëndruar deri në ora 22:30 dhe më pas me dy automjete kanë shkuar në restorant “S. P.”, kanë pirë kafe e pastaj me kërkesën e R. Th. kanë dalë dhe kanë shëtitur me automjetin e tij deri pas mesnate dhe janë kthyer deri te një rrugë përkaj lumit “Lumbardhi”, në një moment R. e ka ndaluar automjetin dhe kur ka dalë jashtë është takuar me dy persona. Pastaj kanë dalë edhe të tjerët, ai i ka thënë R. se dëshiron të shkojë në shtëpi, ka dëgjuar A. i cili po ashtu ka thënë se edhe ai dëshiron që të shkojë në shtëpi por R. në një momenti i ka thanë që ta presë te vendi ku janë të ndalur bagerat, ashtu që në atë vend ka pritur afërsisht një orë dhe në një moment ka vërejtur se në drejtim të tij kanë ardhur R. Th. i cili në duar kishte një çarçaf të bardhë e pas tij D. B. dhe A. M.. Kur është afruar Reshati i ka thënë që ta përcjellin dhe së bashku kanë shkuar deri te parkingu “A. 2” ku e ka pasuar të parkuar automjetin, të katërtë kanë hyrë në automjet, ai ka vozitur automjetin dhe kanë shkuar në një vend tjetër ku në një parking ka lënë automjetin, çelësat i aka marrë R. Th. dhe sipas fjalëve i njëjti ka shkuar dhe ka marrë gjërat prej automjetit të cilat ishin në automjet, por nuk e di ku i ka dërguar. I kujtohet që R. Th. ka ardhur në atë kafene ku kanë pirë kafe me A., ia ka dorëzuar çelësin e automjetit dhe para se të skonte në shtëpi ka shkuar te një vullkanizer për ta rregulluar gomën. R. Th. nuk i ka dhënë para. Për grabitje ka kuptuar në orët e pasditës, e ka ftuar në telefon D. B. dhe ka kërkuar që të takohet, kanë lënë takimin në Suharekë dhe gjatë bisedës D. i ka thanë se R. Th. nuk lajmrohet në telefon e kur e ka pyetur pse ka thirrur R., D. i ka treguar se derisa ai priste te vendi i cekur, ata kanë kryer grabitjen duke hyrë në një shtëpi ku kanë marrë material, duke menduar në gjërat e vjedhura, edhe atë një sasi të parave dhe stoli të arit, ashtu që nga kjo bisedë ka kuptuar për grabitjen. Po atë ditë ka shkruar një mesazh R. duke i thanë “çka je tu bo” apo “çka ke bo”, nuk i kujtohet, por përgjigje nuk ka marrë.

Në shqyrtim kryesor ka shtuar se e njeh R. Th. diku dhjetë vjet, sa herë ka ardhur në pushime në Kosovë, ka shkuar në lokalit e tij në fshatin K.. Po ashtu e njeh edhe A. M., njëherë janë takuar në Gjermani e pasi është kthyer në Kosovë një herë e ka takuar në Suharekë në vitin 2015, por nuk janë shoqëruar. D. nuk e ka njohur. Me datën 05 apo 06 tetor të vitit 2016, dikush ka caktuar takimin me A. dhe në Suharekë në një lokal kanë pirë kafe dhe bashkë me automjetin e tij “Renault Twingo”, kanë shkuar në Prizren dhe pas një shëtitje, diku në ora 18:00 kanë shkuar në restorantin e R. Th.. Aty kanë pirë alkool, nuk e di

sa kanë qëndruar por i kujtohet se pas një kohe ka ardhur edhe D. B.. Qëllimi i shkuarjes ka qenë që prej R. të blejë marihuanë dhe ai i ka premtuar se do ta sigurojë, aty kanë qëndruar deri në orët e vona, pastaj me automejtin e R. i kanë dërguar D. dhe A. tek pompa e benzinës dhe janë kthyer deri te restoranti e R. për ta marrë automejtin e vet i cili ka qenë i parkuar aty. Pasi ka qenë në gjendje të dehur, R. i ka propozuar që ta dërgojë në shtëpi por nuk ka pranuar dhe vetë me makinë është nisur për në shtëpi. Nuk është e vërtetë që natën kritike kanë shkuar te restorant “S. P.”. Është e mundur që ka deklaruar në prokurori se më pas që të katërtë kanë pirë kafe dhe më pas me kërkesën e R. kanë dalë dhe kanë shetituar me automjetin e tij, por kur ka dhënë deklaratën e parë në prokurori ka qenë në paraburgim në Qendrën e paraburgimit në Prizren, ndërsa D. ka qenë në Qendrën e Dubravës dhe ai ia ka dërguar një letër me të cilën e ka udhëzuar se çka duhet të deklarojë në prokurori, ashtu që më vonë ka dhënë deklaratën e dytë sipas udhëzimit. Këtë letër ia ka sjellë një i paraburgosur i cili ka qenë i transferuar prej Dubravës në Prizren, por atë person nuk e njeh. Është e mundur që në prokurori ka thënë se janë kthyer në një rrugë përkaj lumit “Lumbardhi” dhe se në një moment R. Th. e ka ndalë automjetin, ka dalë jashtë dhe është takuar me dy persona e pastaj kanë dalë edhe të tjerët dhe kur R. i ka thënë se donë të shkojë në shtëpi, i njëjti i ka thënë që ta presë në një vend ku janë të parkuar bagerat. Nga D. B. ka pasur presion sepse te D. në QP ka shkuar një polic dhe i ka thënë “gjeje edhe një njeri që të deklaroj, më mirë është për ty, përndryshe edhe ty kanë me të mbajtë në burg”, ashtu që është mashtruar duke menduar që kjo deklaratë do të lehtësojë dhe ka dhënë një deklaratë në prokurori ashtu siç është përshkruar në procesverbal të datës 07.02.2017”, mirëpo ka kuptuar se ka gabuar. Me D. B. për herë të parë është takuar në restorant “A. C.”, nuk e di D. a ka konsumuar alkool atë natë. Me datën 13.10.2016, deri sa ka qenë në shtëpi ka ardhur policia dhe e ka arrestuar.

I akuzuari A. M. në procedurën paraprake në mbrojtjen e vet ka theksuar se e njeh R. Th. si pronar i restorantit “A. C.” ku ka muzikë dhe femra që punojnë si shërbyesë. R. S. e njeh sepse në vitin 2015 ka qenë në Zvicër te vëllai dhe kur ka shkuar në Gjermani ka takuar R. disa herë dhe kanë pirë kafe. Në Kosovë R. S. e ka takuar në Suharekë te stacioni i autobusave, e herën e fundit para arrestit janë takuar në një restorant kur i ka kërkuar që të dërgojë në Pejë, por nuk i kujtohet çfarë automjeti ka pasur. Me datën 06.10.2016 i kujtohet se me prindin ka ardhur në Prizren për të kryer disa punë e pasdite është kthyer vetë në shtëpi, nuk i kujtohet a ka komunikuar me dikë në telefon. Të hollat të cilat janë gjetur në xhepin e tij në shumë prej 530 € ia ka dhanë babai për të blerë diçka për fejesë, por ka ndodhur që edhe e fejuara e tij i ka dërguar të holla në shumë prej 150 €, përmes “Western Union”. Në deklaratën e mëvonëshme ka shtuar se ditën kritike me të akuzuarin R. S. është takuar në qytet rreth orës 19 – 20 dhe me automjetin e R. t kanë shkuar tek pompa e benzinit “S. P.” në afërsin e spitalit në Prizren. Rrugës R. S. i ka thanë se aty do të takohet me R. Th. nga i cili donte të furnizohej me narkotik dhe kur kanë shkuar në restorant është takuar me R. Th. i cili ishte me të akuzuarin D. B.. Aty kanë qëndruar për afërsisht gjysmë orë, derisa kanë pirë kafe të dy R. kanë biseduar për narkotik, R. Th. i ka thanë R. S. se duhet të shkojë në një vend të caktuar për ta siguruar narkotikun. Pasi ka dëgjuar këtë bisedë i ka thënë R. S. që ta kthejë deri te pompa “H. P.” nga më lehtë mund të shkojë në fshat, ashtu që ky fundit e ka dërguar te vendi e ai është kthyer nga kanë ardhur dhe më vonë prej tij ka dëgjuar se aty kanë qenë R. Th. dhe D. B. me dy persona tjerë. Të nesërmen ka kërkuar prej R. S. që ta dërgojë në Pejë. Nuk ka qenë në atë grup i cili ka kryer veprën penale në fjalë. Derisa ka qenë në paraburgim, në koridor dhe në oborrin e burgut ka dëgjuar se këtë vjedhje kanë kryer R. Th. dhe dy persona të tjerë. Në deklaratën e dhënë në shqyrtimin kryesor ka theksuar se qëndron pranë deklaratës së dhënë me datën 06.02.2017, se është arrestuar me datën 20.10.2016, rreth orës 16:00 në QT “Viva Fresh” derisa ishte bashkë me të fejuarën dhe me

prindërit.përndryshe D. B. e njuh nga burgu i Dubravë ku në të njëjtën kohë kanë vuajtur dënime për një vepër tjetër penale. Me datën 05.10.2016 R. S. e ka takuar në Suharekë në ora 14:00 dhe kanë pirë kafe pastaj me automjetin e tij janë nisur në Prizren, përsëri kanë pirë kafe në një lokal te rrethi në Lagjen B. dhe kanë biseduar për bari, ku R. i ka thanë se e njuh një person i cili mund të gjejë barin dhe kanë shkur në restorantin “A. C.” diku kah ora 16 – 17:30 minuta, e kanë takuar pronarin e restorantit R. Th. dhe kanë biseduar për drogë. Nuk i kujtohet në ato momente a ka qenë prezentë D. B. apo ka ardhur më vonë. Janë marrë vesh që të takohen të nesërmen në atë restorant rreth orës 10:00 – 12:00, për ta marrë narkotikë. I kujtohet se ka pirë 2- 3 gota “ Jack Daniels” me “coca-cola”, aty kanë qëndruar deri te ora 22:00 - 22:30 minuta, ai dhe R. S. kanë kërkuar mariuhanë ndërsa D. diqka tjetër prej narkotikëve. Prej restorantit, R. Th. me automjetin e tij, sa i kujtohet të tipit “Mercedes”ngjyrë hiri apo bardhë, e ka dërguar tek pompa e benzinit “Hib Petrol”, R. S. ka qenë i dehur dhe nuk ka qenë në gjendje që të voziste automjetin e vetë. Për rastin e grabitjes ka dëgjuar nëpërmjet mediave- TV, gazetata, facebook. Me datën 06.10.2016, sipas marrëveshjes për të siguruar substancën narkotike rreth orës 11:30 apo 12:00 ka shkuar te restoranti “A. C.” për herë të parë, por ka shkuar edhe në ora 15:00, ku ka takuar një punëtor apo roje i cili e ka informuar se R. Th. është arrestuar. Përndryshe merret me punët e shtëpisë, ka punuar edhe jashtë vendit, i ka vëllëzërit në Zvicër, babai është pensionist i Zvicres andaj e ka gjendjen e mesme ekonomike, ka ndodhur që e fejuara kur ka ardhur në Kosovë t’i ketë sjellë para por edhe i ka dërguar përmes “Vestern Union”, madje sa i kujtohet diku në muajin nëntor 2015, e fejuara ka fituar një konkurs të sigurimit në Gjermani dhe i ka dërguar para si dhuratë. Nuk është e vërtetë që në prokurori ka deklaruar se R. S. dhe R. Th. kanë biseduar rreth narkotikut me ç rast R. Th. i ka thënë se duhet të shkojë ne një vend të caktuar për të siguruar narkotikun, se ka kërkuar prej R. S. ta dërgonte deri te pompa e benzinit “H. P.” dhe se R. S. e ka dërguar në atë vend e kur është kthyer në restorant ka takuar R. Th. dhe D. B.. Është e vërtetë se ka deklaruar se qëndron pranë deklaratës së dhënë në prokurori me datën 06.02.2017 por ashtu siç spjegoi në shqyrtimin kryesor e jo ashtu si është e shenuar në procesverbal dhe precizon se nëse restoranti i R. Th. thirret “S. P.” atëher ka qenë aty, por e di se ka qenë në restorant “A. C.”, është e vërtetë se e ka nënshkruar deklaratën në datat e përmendura, por në asnjë seancë tjetër nuk ka lexuar asnjë procesverbal, prandaj gjithmonë ka ngritur zërin se ka nënshkruar procesverbalet pa i lexuar. Pas datës 06.10.2016 është takuar me R. S. dhe kanë pirë kafe ndërsa D. e ka thirrur në telefonë dhe e ka pyetur se a është i interesuar me dal jashtë vendit por ka refuzuar propozimin duke i thënë se i ka ardhur e fejuara dhe për të dalë jashtë vendit dëshiron të rregullojë letrat në mënyrë të rregullt. Sa i kujtohet ka pasur numrin e telefonit *numri i telefonit....* Sa i përket hartografisë e cila tregon se ky numër telefoni ditën kritike në ora 02:13 minuta, ka qenë fare pranë vendit të ngjarjes, është e çudishme dhe interesant sepse në atë kohë ka qenë në shtëpi, andaj pse hartografia nuk ka vërtetuar se në ora 04:45 minuta, ka hyrë në veturë, kur pretendohet se është parë në kamera, apo kur ka qenë tek restoranti “H. P.”. Lidhur me këtë rast ka pasur presione prej policit A. B. i cili e ka takuar babain dhe i ka thanë se do t ishte më mirë të pranojë fajësinë dhe më mirë ia qet me të, po ashtu edhe një gardian në QP në Prizren me emër B. i cili i ka thanë “të ka bërë të fala A.”. D. B. nuk i ka dërguar ndonjë letër .

I akuzuari D. B. në procedurën paraprake në mbrojtjen e vet ka theksuar se me datën 25.01.2017, është ndalë nga policia dhe është sjellë në stacionin policor në L. ku kanë treguar se ekziston dyshimi ndaj tij. Gjatë dhënies së deklaratës ka qenë prezent avokati i caktuar sipas detyrës zyrtare Z. K.. R. Th. e njuh si pronar i restorantit “A. C.” të cilin ka vizituar shpesh këto 3 - 4 vite. R. S. e ka takuar natën kritike dhe me siguri ai është shoku i R. Th. ndërsa A. M. e ka njohur derisa kanë qenë bashkë në burg. 5 – 6 ditë para ditës kritike është liruar nga burgu prandaj nuk e di nëse të tjerët kanë pasurë ndonjë marrëveshje paraprake.

Atë ditë i ka takuar R. Th., R. S. dhe A. M., kanë qenë me dy automjete, R. Th. me automjetin “Fiat Punto” ndërsa R. S. me A. M. kanë qenë në veturën “Renault”. R. Th. ka ndalë veturën dhe ka hyrë brenda, i kujtohet se ishte ora 17:00, kanë bërë disa xhiro nëpër qytet, kanë vazhduar deri në lagjen afër spitalit dhe janë ndalur në restorantin “S. P.” ku kanë qëndruar një kohë dhe pirë kafe, më pas kanë shkuar ka lagja e stadiumit, kur R. Th. i ka thënë se dikush i paska borxh atij dhe është duke e pritur atë person që të kthehet nga puna. Nuk ka ditur se kush është në pyetje por prap janë shetituar nëpër qytet dhe dikur rreth orës 23:00 janë kthyer në të njëjtin vend, R. Th. ka parkuar veturën në afërsi të ambëltores “Daja”, nga kanë ecur këmbë deri në restorantin “S. “. janë ulur në një tavolinë dhe R. Th. i ka treguar se kanë ndërmend të hyjnë në një shtëpi të një personi, nuk i kujtohet a ka përmendur emrin, mirëpo ka reaguar duke i thënë se nuk dëshiron të hyjë me ta brenda asaj shtëpi, ashtu që ata i thanë që të qëndronte jashtë në rrugë për të bërë roje. Ka pranuar dhe së bashku me ta ka shkuar në këmbë deri në shtëpinë e caktuar. Nuk mund të thotë se kanë pasur maska, por kanë pasur kapela dhe disa gjëra të tjera, para se të hynin në shtëpi ka vërejtur se R. Th. kishte një pistoletë 7.68mm. Në atë vend ku ka bërë roje, i kujtohet se ka qëndruar 30 – 40 minuta kur kanë ardhur R. Th. i cili në duar ka pasur një qarshafë të bardhë, në fillim nuk ka pa se çka ka pasë brenda por më vonë ka kuptuar se aty kishte para dhe ari por nuk e di sa, si dhe R. S. dhe A. M.. Shpejtë janë larguar deri te parkingu “A. 2” ku ishte i parkuar automjeti dhe janë larguar në drejtim të kishës katolike ku është shpërthyer goma, prandaj ka dal nga vetura dhe me A. janë nisur në këmbë, kanë marrë një taksi dhe kanë shkuar deri në B. në një piceri “L.” ku kanë qëndruar një kohë, ndërsa dy R. kanë shkuar veç. Para se të ndahen R. atij dhe A. u ka dhanë nga 100 €. Të dy R. diku në orët e mëngjesit kanë ardhur në restorant “L.”, kanë qëndruar një kohë dhe më pas kanë shkuar në fshatin C. në shtëpinë e R. Th. i cili me automjetin e babasë ka shkuar deri te kisha e katolikëve ku i ka marrë gjërat e vjedhura dhe është kthyer në shtëpi. Ai nuk ka treguar sa para ka pasur në qarshaf por ia ka dhënë 1.000 € duke i thanë se pasi ta shesë arin e vjedhur do t’ia japë edhe diçka tjetër, aty ka kuptuar që përposë parave ka pasur edhe ari. Në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se nuk i kujtohet ku ka qenë paradite por pasdite ka shkuar në restorantin “A. C.” në fshatin K., ku ka biseduar me R. Th. dhe ka pirë bira. Pas rreth një ore kanë ardhur A. dhe R. S. dhe kanë ndejtur deri në ora 23:30 minuta, duke biseduar për drogën kokaina, të cilën e ka kërkuar dhe janë marrë vesh që të takohen të nesërmen. Pastaj me veturën e R. Th. kanë shkuar deri te pompa “H. P.” ku me A. janë ndarë dhe kanë shkuar nëpër shtëpi ndërsa dy R. janë larguar. Të nesërmen sipas marrëveshjes ka shkuar të takohet me R. Th. në restorantin e tij por prej një punëtori ka kuptuar se R. është arrestuar. Sa i përket ndryshimit të deklaratës thekson se atë ditë kur është arrestuar, polici A. B. ka qenë kryesuesi i grupit, e kanë maltretuar, ia kanë shqyer jaknën duke i thanë se “asgjë nuk i kanë bërë çka do të bëjnë atje”, e kanë sjellë në Stacionin Policor dhe pa prezencën e avokatit dy orë e kanë maltretuar, gjatë dhënies së deklaratës i kanë thënë se ka edhe 20 vepra të tjera, disa me fakte e për të tjerë as që ka ditur, po ashtu i kanë thënë se nëse deklarohej që këtë vepër penale ke bërë së bashku me R. Th., A. M. dhe R. S. do të dënohet me një vit e gjysëm, e në të kundërtën do të përgjigjet për të gjitha veprat dhe do të dënohet minimum 10 vjet burgim. Nuk ka kuptuar që e ka garancion për lehtësim por në atë momentë polici A. ka kontaktuar prokurorin e pastaj i ka thanë se po i argumenton se nuk do të dënohet më shumë se një vit e gjysmë apo dy vite me burg dhe se të gjitha veprat e tjera do t’i eliminojnë. Pastaj ka lëshuar interfonin dhe vetë ka dëgjuar kur prokurori i ka thanë se nëse bashkëpunon do të dënohet me 20 – 25 % më lehtë, pastaj prokurori e ka pyetur a ka avokatin dhe kur polici e ka thanë se jo, prokurori i ka thanë që mos ta lë konsultimin me avokatin dhe së pari le t’ia marrë deklaratën e pastaj le të vijë avokati dhe ky e nënshkruan deklaratën, ashtu ka ndodhur, pasi ka nënshkruar deklaratën avokati e ka pyetur se a është e vërtet kjo deklarata e tij. Në prokurori nuk ka qenë në gjendje të japë deklaratë, andaj prokurori ia ka lexuar deklaratën e dhënë në polici, të cilën deklaratë

e ka pranuar në tërësi përveç te pjesa se kush ka hyrë në shtëpi , ai ka thanë R. Th., A. M. dhe një djali zeshkan prej Suharekë, atëherë prokurori ka përmendur emrin e R. S. dhe ati ka thanë se “po ai është” dhe aty ka përfunduar deklarata të cilën e ka nëshkruar. Dy javë më vonë, nuk i kujtohet a ka qenë data 15, 16. 02.2017 kur në Dubravë ka ardhur polici i njejtë me dy policë të tjerë dhe i ka thanë që të mbetet pranë asaj deklarate që ke dhënë, duke i treguar për disa vepra penale duke i thënë që nëse nuk i përmbahet asaj deklarate siç janë marrë vesh, atëherë të gjitha ato raste do t’i dërgojë në prokurori, po ashtu i ka thanë që nëse mund ta gjente edhe dikë tjetër prej këtij grupi që t’i ndihmojë lidhur me atë deklaratë, për të qenë më e fortë dhe bindëse, pas kësaj bisede ka shkruar një letër të cilën ia ka dhënë një të burgosurit nga Peja me emër V., i cili është transferuar në burgun e Prizrenit, me porosi që t’ia dorëzojë R. S.. Pas 15 dite prej dërgimit të letrës ka qenë i ftuar në prokurori lidhur me pesë vepra penale të tjera. Nuk e ka interesuar çka ka deklaruar R. S. pasi ka dërguar letrën por polici i ka treguar se çka kanë deklaruar secili prej tyre dhe ka ditur të gjitha deklaratat. Pas natës kritike është takuar me A. dhe R. S., kanë pirë kafe dhe një ditë ka kërkuar prej R. S. që të dërgonë deri në Pejë dhe prej A. ka kërkuar që të shkojnë në Evropë. Sa i kujtohet në atë kohë e ka përdorur numrin e operatorit “Vala” , ka ndruar shumë numra të telefonit por është e mundëshme se ka pasur numrin *numri i telefoni...*, por në atë kohë nuk ka komunikuar me asnjë prej të akuzuarve e pas kësaj date ka komunikuar me R. dhe A.. Përveç R. S. nuk ka dërguar letra për A. M. dhe R. Th..

Gjatë shqyrtimit kryesor janë lexuar provat materiale dhe atë:

-raporti mjekoëso me nr. 9236, e lëshuar nga Emergjenca e Spitalit në prizren me ndatën 06.10.2016 , për të dëmtuarin K. H. dhe raporti mjekësor me nr. 9237, të lëshuar nga Emergjenca e spitalit të Prizrenit me datën 06.10.2016 për të dëmtuarin D. H., në bazë të cilëve është siguruar akt ekspertimi me nr, ererencës 01/2017, Z.SH “ ekspertiza kotori” – ekspertiza mejko ligjor për të dëmtuarin D. H. dhe K. H. ku konstatohet se i dëmtuari D. H. ka pësuar ndryshje (mbretje) me ënjtje të indeve të kokës, gërvishitje dhe dërmishje lëkurore të dy anëve të regjionit të qafës, gjakmbledhje nënlëkurore të regjionit muror të anës së majtë të kokës, plagë çarëse-shqyrëse të indeve të buta të regjionit të laprës së veshit të majtë, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo i mbrehtë, i topitur) dhe si të tilla , një nga një dhe së bashku, bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore dhe me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, ndërkaq e dëmtuara K. H. ka pësuar një gjendje pas ndrydhjes (mbretjes) së kokërdhokut të syrit të mjaët, gjakmbledhje nënlëkurore të kapakut të syrit, gjakderdhje konjuktivale të syrit pas traumës, gjendje pas ndryshjes së indeve të buta dhe gjakmbledhjs nënlëkurore të regjionit të syrit të majtë, të regjionit ballor të kokës, të regjionit për rreth laprës së veshit të majtë, ndrydhje të indeve të buta me gjakmbledhje nënlëkurore të fytyrës, gjakrrjedhje nga kanali i eshit të majtë dhe thyerje e cokës së hunsë, një nga një dhe së bashku, bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore dhe me dëmtim të përkohshëm të shëndetit;

-raporti e listingut hyrje daljeve për numrat e lefonave të akuzuarve A. M., D. B., R. Th. dhe R. S. nga e cila vërtetohet se personat në fjalë kanë kontaktuar vazhdimisht një ditë përpara dhe pas ngjarjes dhe se në momentin e incidentit kanë qenë afër shtëpisë së të dëmtuarit;

-raporti informues i datës 14.12.2016 lidhur me gjetjeve nga Skuadra Rajonale e hetimeve në telefonin e të akuzuarit R. Th., A. M. dhe lidhur me imazhet e pastruara të nxjerra nga video sekuencat për rastin në fjalë;

-është bërë shikimi në video incizim nga CD-ja me nr. rendor 1 në të cilën shihet mbrendia e një restorantit, e datës 05.10.2016 prej orës 22:00 deri në ora 22:25 minuta, i cili video incizim është marr nga kamera e restorantit “S. P.”, afër spitalit në Prizren.

-është bërë shikimi në vido incizim, nga CD-ja me nr. erendor 2 lidhur me veturat me targat e regjistrimit *numri i targës...* e tipit “Renault Twingo”, dhe me numër të regjistrimit *numri i targës...* e tipit “Fiat Punto”;

-është bërë shikimi në vido incizim nga CD me nr. rendor 3 nga e cila shihet se prej parkingut “A. 2” është marr vetura “Renault Twingo”, në orët e vona .

-është bërë shikimi në fotodokumentacion nga e cila shihet brendia e shtëpis e të dëmtuarve, në rr. ... në Prizren , dëmtimi i derës së hyrjes në shtëpi, në pjesën e drynit nga pjesa e jashtëme, brendia e koridorit dhe dhomat në katin e parë dhe të dytë si dhe në dhomën e fjetjes të dëmtuarit ku shihen dëmtime në pjesën elektronike për shpërndarje të kanaleve televizive, këputja e kabollove të rymës së paisjes elektronike për shpërndarjen e kanaleve televizive dhe heqja kallbos që lidh pasijen elektronike për shpërndarje të kanaleve televizive me televizor, i cili kabëll është gjetur në dysheme të dhomës, përballë derës ;

-është bërë leximi i vërtetimit mbi marrjen e përkohëshme të sendeve nga i akuzuari A. M. në të cilën konstatohet se janë konfiskuar të hollat në vlerë prej 530 € ;

-lista e dëshmvive të datës 13.10.2016, dosja e forenzikës HS – TK 309/16, dosja e hetimeve 2016 – GA- 2526 lidhur me bastisjen në shtëpine e të akuzuarit R. S. , në fshatin S. prej të cilit janë kofiskuar disa telefona, një laptop katela e telefonave kompanisë “Ipko”, “Vala”, certifikata e regjistrimit të automjetit , një kartelë e bankës , një pasaportë, një tiket kundërvajtjes;

-është lexuar raporti i egzaminimit të veturës e markës “Fiat Punto” me targat e regjistrimit *numri i targës...* të datës 11.10.2016, numri i dosjes TT- 78/2-2016 nga e cila del se është bërë kontrollimi dhe procesimi i pjesës së mbrendëshme të automjetit “Fiat Puto” ne ngjyrë të bardhë ku janë gjetur si dëshmi e evidentuar #1E #1.1E, #2E, #4E, #4.1E, #5E, #6E, #7E, #P edhe atë një trenerkë e epërme sportive , ngjyrë hiri me mbishkrim “Adidas”, një xheper ngjyrë hiri në të altërt, një qese najlloni, një çantë lëkure ngjyrë kafe me mbishkrim JEEP ku mbrenda ishin një pasaportë në emër të R. Th. , dy simë kartelë (mbajtës) , 7 filtra të cigarve me mbishkrim “Prestige”, një filterë me mbishkrim “Mallboro”, një filter me mbishkrim “Wilston” dhe një filter me mbishkrim “Lucserc”. një shufër besbollid, një palë patika, një telefon “Nokia” dhe një trakë ngjitëse “izolir” ;

-bëhet shikimi në foto album lidhur me rastin e ekzaminimit e veturës e përmendur nga të cilat shihen se është në fjalë vetura “Fiat Punto” me targ. të regjistrimit *numri i targës...* me ngjyrë të bardhë dhe sendet e gjetura në automjetë.

-është lexuar raporti nga Qendra e Paraburgimit në Prizren – njoftimi në të cilin konstatohet se pa verifikimit të data bazës të Institucionit, gjatë periudhës 01.02.2017 deri më 06.02.2017, QP në Prizren nuk ka pranuar asnjë person me emër V. as nga QP në Pejë e as nga QK në Dubravë.

Në bazë të provave të administruara gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

I akuzuari R. Th., A. M., R. S. dhe D. B. njihen në mes vete. I akuzuari R. Th. është pronar i restorantit “A. C.” në fshatin K. , aty ka muzik të gjallë dhe disa vajza të cilat shërbejnë, përveç të tjerve edhe të akuzuarit e vizitojnë këtë restorant. Përveç që njihen edhe nga ky rreshtoranti, i akuzuari R. S. dhe R. Th. njihen më shumë se 10 vite sepse R. Th. është dhëndër i fshatit S. nga është edhe R. S., ky i fundit dhe A. M. po ashtu njihen që më herët, nga viti 2015 kur kanë qenë bashkë në Gjermani si azilant dhe pasi janë kthyer në Kosovë kanë vazhduar të shoqërohen. A. M. dhe D. B. njihen nga burgu në Dubravë ku kanë qenë në vuajtje të dënimit për raste të tjera. Një ditë para ditës kritike i akuzuari R. S., në marrëveshje paraprake me automjetin e vet “Renault Twingo” me regjistrim *numri i targës...* rreth orës 18:00 ka ardhur në Prizren dhe është takuar me A. M., në një lokal kanë pirë kafe, pastaj kanë shetituar nëpër qytet dhe kah ora 21:00 te rrethi tek dalja e Prizrenit janë takuar me të akuzuarin R. Th. i cili ishte me veturën e vet të markës “Fiat Punto” bashkë me D. B. dhe janë marrë veshë që të takohen në restorant i pompës të benzinës “S. P.” që gjendet afër spitalit rajonal të Prizrenit, i akuzuari R. S. ka parkuar automjetin e vetë në parkingun i QT “A. 2” . Pasi kanë pirë kafe, kanë dalë për të bërë gjiro me veturën e të akuzuarit R. Th. , pastaj kanë arritur te lagja ku gjendet stadiumi , ku i akuzuari R. Th. ka parkuar automjetin e vetë afër ëmbëltores “D.” dhe këmbë përsëri kanë shkuar deri te restoranti “S. P.”. Aty kanë biseduar për të hyrë në një shtëpi. Të paisur me gjësendet të nevojshme si kapela, doreza, kaqavidha, thika të gjitha këto për të evituar pengesat, ndërsa i akuzuari R. Th. i paisur me pistoletë, kanë pritur momentin e volitshëm ,pasi kanë vërejtur është fikur edhe drita e fundit në shtëpinë e të dëmtuarëve, kanë hyrë në oborrin e shtëpisë, kanë thyer derën e shtëpisë dhe kanë hyrë mbrenda deri në dhomën e fjetjes në kalin e tret, ku ishin duke fjetur dy persona të moshuar, bashkëshortit D. dhe K. H., të cilët dy prej të akuzuarve menjëherë i kanë sulmuar duke i goditur me grushta dhe duke ua mbështetur në fytyrë njëri kaqavidën tjetri thikën, duke u kërkuar që të dorëzojnë paratë. Në momentin kur i dëmtuari D. ka vërejtur se bashkëshortja e tij është në rrezik ka dorëzuar çelsat e kasafortës duke treguar edhe vendin ku gjendet, nga kanë marrë çdo gjë që kanë gjetur aty, parat dhe ari të cilat i kanë mbështjellë në një çarçafë. Pas kësaj një ri prej të të akuzuarve ka prerë kabllon e televizorit me të cilën i kanë lidhur të dëmtuarit, kanë mbyllur dhomën e fjetjes dhe janë larguar nga vendi i ngjarjes, kanë shkuar deri te parkingu e QT “A. 2” ku ka qenë i parkuar vetura i të akuzuarit R. S. i cili është ulur në vendin e vozitësit dhe janë larguar në drejtim të kishës katolike. Në momentin kur i dëmtuari D. H. disi është liruar nga gajtani dhe ka dalë në teracë për të kërkuar ndihmë, ndërkohë kusheriri i tij duke vërejtur se diçka po ndodh në shtëpinë e tyre, menjëher ka ftuar policinë.

Këtë gjendje faktike gjykata ka vërtetuar pjesërisht në bazë të deklaratave të akuzuarve, deklaratave të të dëmtuarve D. dhe K. H., të dëshmitarëve A. H., I. E., N. M. dhe A. B. si dhe provave materiale ekspertizës mjekoligjore, video incizimet, raportet e hyrje daljeve dhe fotodokumentacionit .

Duke patur parasysh se deklarata e të akuzuarit mund të jetë mjetë provues edhe në raste kur pranohet fajësia por edhe në ato raste kur nuk përmbanë praninë, dhe elementet e veprës nuk nxiren vetëm nga ajo pjesë e deklaratës e cila përmban praninë e veprës, por nga të gjithë pjesët e deklaratës të cilat kanë të bëjnë me faktet të cilat janë objekt i të provuarit, gjykata ka vlerësuar mbrojtjet e të akuzuarve dhe i ka verifikuar ato edhe me anë të mjeteve të tjera provuese dhe ka vlerësuar se, në fakt mohimi i tyre që kanë kryer veprën penale është vetëm një mohim i pabazë me disa pohime të cilat lejojnë disa momente të akuzës. Në fakt i akuzuari R. Th. në deklaratën e parë është mbrojtur se natën kritike ka qenë në një lokalë afër tregut të gjelbër në Prizren, pronë e R. Zh., ku ka luajtur me letra deri në ora 22:00, e pastaj ka shkuar deri në Suharekë nga bashkë me të dashurën e tij ka vazhduar rrugën deri

në Ferizaj me qëllim që të furnizohet me drogë, në kthim është ndarë nga e dashura në Suharekë dhe ka vazhduar deri në restorantin e tij “A. C.”. Ndërsa në deklaratën e më vonëshme i akuzuari ka lejuar mundësinë që atë natë ka qenë në restorantin “S. P.” afër spitalit ku është takuar me të akuzuarit R. S., A. M. dhe D. B. dhe pasi kanë pirë kafe, ka shkuar në Suharekë e pastaj në Ferizaj.

Meqenëse i akuzuari në një pjesë të deklaratës së tij mohon të dhënat nga akuza, ndërsa në pjesën tjetër pjesërisht pranon disa momente nga akuza, gjykata ka verifikuar dhe vlerësuar besueshmërinë e deklaratës së tij lidhur me tërësinë e të gjitha provave në dispozicion dhe ka nxjerr konkluzion se mbrojtja e tij është drejtuar në shmangëjen e përgjegjësisë penale juridike dhe se e njehta është në kundërtënie me mbrojtjen e të akuzuarit R. S., ky i cili në deklaratën paraprake ka përshkruar në mënyrë detaje ngjarjen e natës kritike duke theksuar se me marrëveshje me A. janë takuar në Prizren diku rreth ora 18:00 dhe pasi kanë bërë një shetitje nëpër qytet, në rrugë diku te rrethi janë takuar me të akuzuarit R. Th. dhe D. B. , janë marrë veshë që të gjithë të takohen përsëri në restorantin “S. P.” dhe me kërkesën e R. Th., me automjetin e tij kanë shetituar deri pas mesnate dhe janë ndalur në një rrugicë përkaj lumit Lumbardhi ku ai ka pritur në një vend deri sa ata të tjerët kanë hyrë në shtëpi, pas një ore ka parë R. Th. i cili në duar ka pasur një çarçafë, me të ishin D. dhe A., pastaj së bashku kanë shkuar deri te parkingu i “A. 2” , ku ai kishte lënë veturën, ka hyrë në vendin e vozitësit dhe janë nisur deri te një parkingu tjetër, R. Th. ia ka marrë çelësat e veturës, ka shkuar për t’i marrë gjërat nga automjeti ndërsa ai me A. kanë qëndruar në një kafeteri derisa i ka kthyer çelësat .

Gjykata ka pranuar këtë pjesë të mbrojtjes të të akuzuarit R. S. meqë e njehta përputhet me deklaratën e të akuzuarit A. M. i cili, edhe pse ka mohuar kryerjen e veprës penale, ka deklaruar se me të akuzuarin R. S. është takuar në qytetë rreth ora 19:00 dhe me automjetin e R. kanë shkuar deri te restoranti “S. P.” afër spitalit, se rrugës R. S. i ka thanë se do të takohet me të akuzuarit R. Th. dhe D. B..

Kjo pjesë e mbrojtjes të të akuzuarit R. S. përputhet edhe me pjesën e deklaratës e të akuzuarit D. B., i cili po ashtu në mënyrë detaje ka përshkruar rastin e natës kritike duke theksuar se atë ditë deri sa ka ecur ka takuar të akuzuarit R. Th., R. S. dhe A. M., kanë qenë me dy automjete, ai ka hyrë në veturën e R. Th., kanë bërë xhiro nëpër qytet dhe kanë vazhduar deri në restorantin “S. P.” ku kanë qëndruar një kohë, pastaj kanë shkuar në lagjen e stadiumit ku R. Th. i ka thanë është duke pritur një personqë i ka borxh dhe diku në ora 23:00, janë kthyer në restorantin “S. P.” , kanë qenë të ulur së bashku me një tavolin me ç’rast R. Th. ka treguar se kanë ndërmend të hyjnë në një shtëpi të një personi, ka pranuar që të bëjë rojen dhe së bashku kanë shkuar në këmbë deri në shtëpi, ata kanë pasur kapela dhe disa gjëra, ndërsa i akuzuari R. Th. ka pasur një pistolet, në atë vend ku ka bërë roje ka qëndruar 30 – 40 minuta e kur kanë ardhur R. Th. në duar ka pas një çarçafë të bardhë, pas tij kanë ardhur R. S. dhe A. M., shpejtë janë larguar deri te parkingu ku ka qenë automjeti i R. S. dhe kanë shkuar në drejtimin e kishës katolike ku në një vend është shpërthyer goma. Me A. janë nisur në këmbë deri në momentin kur e kanë marrë një taksì dhe kanë shkuar deri te B. ku kanë pirë kafe në picerinë “L.”, e dy R. kanë shkuar dhe janë kthyer në mëngjes, prej aty kanë shkuar në drejtim të shtëpisë R. Th. i cili pastaj me veturën e babait ka shkuar për t’i marrë gjërat te kisha katolike dhe kur është kthyer, ia ka dhanë 1.000 € duke i thënë se kur ta shesë arin e vjedhur do t’ia japë edhe diçka tjetër.

Gjykata ka analizuar deklaratat e të akuzuarve dhe besueshmërinë e tyre ka verifikuar përmes rrehanave se nuk ka kundërtënie në mes të fakteve të tjera dhe përshkrimit real i cili

udhëzon në një të vërtet më të afërt, si dhe që paraqitja e disa veçorive unike dhe të posaçme na udhëzojnë se duhet të konsiderohet se ato rrjedhin nga rrethanat reale në bazë të së cilave është vërtetuar si jo kontestuese si vijon: se të akuzuarit njihen që më herët, se shoqërohen dhe kanë kontakte telefonike, se pas ditës para natës kritike me marëveshje kanë ardhur në Prizren, kanë shkuar në restorantin afër pompës së benzinës “S. P.” që gjendet në afërsi të QT “A. 2” dhe në atë pjesë të qytetit ku të dëmtuarit kanë shtëpinë, se janë marrë vesh të realizojnë planin e hyrjes në shtëpi, se kanë përshkuar rreth e rotull atë lagje duke pritur një moment të përshtatshëm për të hyrë në shtëpi, se kanë poseduar paisjet e nevojshme për ta fshehur fytirën dhe dorëzat, mjetet e nevojshme për evitimin e pengesave si dhe armë, se i akuzuari R. S. në një moment ka parkuar automjetin e vet “Renault Twingo”, në parkingun e “A. 2” edhe atë më larg nga kabina e rrojes, se kanë pritur momentin e volitshëm dhe diku rreth ora 02:30 të katërt kanë hyrë në oborr, kanë thyer drynin e derës hyrëse të shtëpisë dhe kanë hyrë në shtëpi, kanë shkuar në katin e tretë, në dhomën e fjetjes ku të dëmtuarit ishin duke fjetur, dy prej tyre u janë ofruar menjëherë dhe fizikisht e kanë sulmuar duke kërkuar t’i dorëzojnë të hollat dhe gjësendet e tjera me vlerë, pasi kanë marrë çelësin kanë hapur kasafortën nga kanë marrë të hollat dhe stoli të arit të cilat i kanë vendosur në një çarçafë, se para se të largoheshin njëri prej tyre me thikë ka prerë një kabllo televizive dhe me të i ka lidhur të dëmtuarit e pastaj janë larguar nga vendi i ngjarjes në drejtim të vendparkimit ku ishte parkuar vetura e R. S. dhe kanë vazhduar në drejtim të kishës katolike. Këto fakte gjykata ka vërtetuar në bazë të mbrojtjeve të të akuzuarve dhe në bazë të provave në dispozicion në këtë çështje penale në të cilat mbështeten mbrojtjet e të akuzuarve R. S. dhe D. B.. Në këtë drejtim flasin provat materiale edhe atë raporti i hyrje-daljes dhe hartografia, nga vërtetohet se numri i telefonit *numri i telefonit...*, abonenti A. M. me datën 06.10.2016 në ora 02:13 (koha e incidentit është rreth 02:50) ka qenë fare pranë vendit të incidentit, pra pranë rrugës së viktimës D. H., ku ka ndodhur vepra penale dhe se ky numër telefoni disa herë një ditë para incidentit dhe pas, ka kontaktuar me numrin *numri i telefonit...* abonenti R. S., D. B. dhe R. Th., se numri i telefonit *numri i telefonit...* abonent D. B. ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me R. S. dhe A. M., se numri i telefonit *numri i telefonit...*, abonent R. Th. para dhe pas incidentit ka pasur kontakte të vazhdueshme përmes telefonit me R. S. dhe në datën e incidentit ka pasur kontakte me telefon me A. M.. Ky numër telefoni me datën 05.10.2016, në ora 19:25, pra rreth 5 – 6 orë para incidentit ka qenë pranë shtëpisë së viktimës D. H.. Numri i telefonit *numri i telefonit...*, pronë e R. S., në bazë të hartografisë vëtetohet se me datën 05.10.2016, rreth orës 22:1, katër orë para incidentit, ka qenë pranë shtëpisë së viktimës D. H. dhe ka kontaktuar vazhdueshëm me A. M., D. B. dhe R. Th.. Në këtë drejtim ka dëshmuar dëshmitari A. B. i cili ka shpjeguar raportin e hyrje daljes dhe hartografinë duke precizuar se numri i telefonit *numri i telefonit...* abonent A. M. me datën 06.10.2016, në ora 02:13 ka qenë afër lokacionit të viktimës dhe ka kontaktuar me nr. *Numri i telefonit...* abonent R. S., me datë të njejtë në ora 15:46 dhe 17:08. Me datën 05.10.2016, në ora 15:38 është kontaktuar me nr. i telefonit *numri i telefonit...*, i cili është përdorur nga abonenti R. S.. Të njejtën datë në ora 16:07, është kontaktuar në ora 09:47, 11:05, 11:13, 11:37, 12:45, 14:03, 14:19, 15:12, 15:46, 16:14, 17:08. Me datën 07.10.2016, ka kontaktuar me numri i telefonit *numri i telefonit...* abonent D. B. në ora 19:02, 19:04 dhe 20:31. Numri i telefonit *numri i telefonit...* abonent R. Th. më 01.10 2016, në ora 11:48 dhe 14:29, më 02.10.2016 në ora 13:55, 14:15, 15:13, 15:14, 16:04, 18:20, me datën 03.10.2016 në ora 21:00, me 04.10.2016 në ora 18:33, 17:21, 17:24, 18:21, 19:19, 19:36, më 05.10.2016 në ora 13:33, 15:36, 17:40, 18:35, 18:37 dhe me datën 06.10.2016 në ora 12:04, 13:05, 16:13, ka kontaktuar me numrin *numri i telefonit...* abonent R. S. dhe 05.10.2016 ka kontaktuar me nr, *numri i telefonit...* abonentit i panjohur dhe se ky numër telefoni me atë datë ka qenë afër vendit të ngjarjes në ora 19:25. Numri i telefonit *numri i telefonit...* abonent R. S. më

07.10.2016 ka kontaktuar me D. B. në ora 17:58, 22:18, 22:21, 22:23, 22:37, 22:40 dhe me datën 08.10.2016 në ora 12:43, 13:01, 13:46, 14:10, 14:15, 15:28.

Nga raporti i datës 14.12.2016 vëtetohet se me 06.10.2016 rreth orës 05:44, 2–3 orë pas rastit, i akuzuari R. Th. përmes facebook kontakton me një femër H. Q. dhe shkruan mesazh “qoma numrin e K. tja qoj naj lekë”, i akuzuari A. M. përmes telefonit në Web faqe të interneti disa herë ka kërkuar informacion lidhur me rastin e ndodhur me datën 06.10.2016, dhe një ditë pas rastit informon motrën e tij dhe e njofton se i ka dërguar para përmes “Western Union” të fejuarës e cila jeton në Gjermani, e në fotografitë të cilat e ka pas në telefonë ai ekspozohet me armë zjari dhe me një grubull parash. Në bazë të fotografive të marra nga restoranti “S. P.” i cili gjendet në hyrjen e spitalit rajonal të Prizrenit shihet momenti kur në parkingun e QT “A. 2” është parkuar vetura disa orë para kryerjes së veprës nga disa persona të cilit kanë hyrë në restorant, në bazë të krahasimit të imazheve të veturave është vërtetuar ngjashmëri me veturën “Renault Twingo” ngjyrë e kaltër, pronë e R. S. dhe me veturën “Fiat Punto” ngjyrë e bardhë, pronë e R. Th., të cilat janë marrë përmes video sekuecave te parkingut të “A.” para dhe pas kryerjes së veprës penale, të cilat fakte vërtetohen edhe në bazë të vido incizimit dhe foto albumit nga shkresat e lëndës. Se natën kritike të akuzuarit kanë hy në shtëpinë e të dëmtuarve, ka dëshmuar i dëmtuari D. H. i cili ka spjeguar se në shtëpinë në rr. ... jeton që 35 vite. Natën kritike pas orës 12:00 ka shkuar në dhomën e vet për të fjetur e cila gjendet në katin e tretë ndërsa bashkëshortja e tij ka ardhur më vonë sepse ajo zakonisht kontrollon dyert e sendet të tjera para se të flejë. Diku në ora 02:30 minuta është zgjuar nga gjumi dhe ka vërejtur mbi vete një person të maskuar, një pjesë e fytyrës ka qenë e hapur ashtu që ka vërejtur mustaqet dhe një mjekër të shkurtë rreth gojës, ka pasur dorëza, dhe në dorë një thikë me teh diku 10 – 15 cm, personi tjetër ishte mbi bashkëshorten e tij dhe në duar ka pasur një kaçavidë të madhe, ata i kanë goditur permanent me grushta dhe gjësende të forta, sa ka mund të vërejë kanë qenë 5 persona të maskuar, njeri ka pasur çarap të zi, fytyrën e kishte si të ishte i rrezitur. Kur është ngritur nga shtrati ka vërejtur se njeri prej tyre ka pasur një pistoletë në dorë. Pasi ka vërejtur se janë duke goditur bashkëshorten e tij ka dorëzuar çelësat të cilat i ka pasur afër vetes duke i thanë që mos ta godasin të njejtën dhe le të marrin krejt çka duan dhe le të largohen. Vet e ka nxjer çelësat dhe i ka treguar se ku është sefi prapa derës, ata kanë çelë sefin dhe kanë marrë të gjith arin e saj dhe të nuses e cila jeton në Prishtinë, si dhe paratë. Pasi kanë marrë gjësendet i kanë lidhur me një gajtan të televizorit , i kanë lënë të lidhur në dysheme, në dalje kanë mbyllur derën e dhomës dhe janë larguar. Djali i vëllaut A. H. ka vërejtur se diç nuk është në rregull në shtëpinë e tij dhe ka thirrur policinë e cila shumë shpejtë kanë ardhur. Pasi është liruar disa ka dalë menjëherë në ballkon dh eka kërkuar ndihmë. Pasi merret edhe me tregëti dhe shpesh i numëron paratë, i kujthet i kujtohet se dy netë përpara i ka numruar paratë dhe ka pasur 24 banknota prej 500 €, një bankënotë prej 200 €, 39 bankënota prej 100 €, 35 -38 bankënota nga 50 €, përafërsisht në vlerë prej 18.000 €. Para një kohe të shkurtër nga BKT ka nxjerë shumën prej 20.000 €, e sasia e arit ka qenë diku rreth 2 kg. Ata persona kanë folur në gjuhën shqipe mirëpo njeri prej tyre ka ditur gjuhën turke se kur bashkëshortja ka reaguuar në gjuhën turke duke i thanë “se a kanë zotë” ai është përgjigjur po në atë gjuhë. Në dhomën e fjetjes nuk ka qenë e ndezur drita por ka pasur dritë që ka depërtuar nga nga jasht përmes derës së ballkonit. Personi i cili ia ka lidhur duart, me thikë ka prerë gajtanin e televizorit dhe atë gajtan e ka marr policia më vonë. Është e vërtet se televizioni i Klanë Kosovës ka qenë tek ata dhe atyre u kanë treguar se policia e ka zënë grupin por ende nuk kanë dalë në gjykim.

E dëmtuara K. H. ka dëshmuar se natën kritike si zakonisht para fjetjes kontrollon të gjitha dyert e shtëpisë, atë natë ka pasur tension dhe një apo dy herë ka shkuar poshtë për të

marrë terapinë, ashtu që diku në ora 02:00 është kthyer në dhomën e fjetjes në katin e tretë në të cilën ka qenë e ndezur llampa e neonit. Në momentin kur e ka zënë gjumi, në ora 02:30 është zgjuar dhe ka vërejtur disa persona në dhomën e fjetjes ndërsa edhe mbi të edhe mbi burrin kanë qëndruar nja një prej tyre, të cilit i kanë goditur, ajo ishte me fytyrë në jastëk dhe sa ka mund të vërejtë personat kanë qenë me maska dhe me dorëza të vrazhda, ka dëgjuar kur bashkëshorti ka thanë që mos ta godasin, ka vërejtur kur e kanë ngritur nga shtrati dhe e kanë detyruar që ta hap sefin por ajo nuk ka ditur sa para dhe ari ka pasur aty, e di se ka pasur një kuti me gjëra të ndryshme të saj si unaza, zinxhirë të arit etj. si dhe gjërat e vlefshme të nuses e cila jeton në Prishtinë. Te njëri ka parë një revolje, tjetri një thikë dhe personi i cili ka qenë mbi te ka pasur një kaçavidë i cili disa herë ia ka afruar në fyt duke u kërcënuar se do të mbyset. Ka vërejtur kur e kanë nxjerë një çarçafë dhe të gjitha sendet që e kanë marrë i kanë futur aty. Kryesisht kanë folur shqipë por i kujtohet se personi i cili e ka goditur dhe ka qenë mbi të, kur ka thanë në gjuhën turke “ a keni zot ju” i njejt i gjuhën turke ka thanë “ po po na kemi zot po ti a ki zot dhe a ke dhënë sadak”, pastaj të dytë me gajtanin të televizorit i kanë lidhur duart, i kanë lënë të ulur në dysheme dhe e kanë mbyllur derin e dhomës duke u larguar. Bashkëshorti disi i ka liruar duart, ka hapur derën, ka dalë në ballkon dhe ka bërë titur për ndihmë. Djali i kumatit i cili është kojshi ka vërejtur shumë njerëz në shtëpi, ka zgjuar babanë e tij nga gjumi dhe kanë njoftuar policinë, në atë situatë shumë të rëndë ka qenë e shokuar dhe nuk do të harojë deri sa të vdesë, ende është e stresuar dhe ka probleme me gjumë. Nuk e din si kanë hyrë në oborr por dera e hyrjes e shtëpisë ka qenë e thyer dhe dryni i prishur.

Në këtë drejtim ka dëshmuar dëshmitari A. H. i cili ka theksuar se të dëmtuarin D. H. e ka axhë dhe jetojnë afër, një murr i ndanë. Nuk i kujtohet sa ka qenë ora natën kritike, por diku pas mesnate djali i tij ka dëgjuar disa zëra, ka ardhur në dhomën e tij dhe e ka zgjuar duke i thanë se diçka po dëgjohej nga shtëpia e axhës. Ka dalë nga dhoma në ballkonë dhe ka kaluar në ballkonin e axhës e prej aty ka vërejtur vetëm siluetat e njerëzëve dhe ka dëgjuar zëra dha bërtima. Është kthyer përsëri në ballkonin e tij, ka shkuar në dhomë dhe me telefonin e bashkëshortes ka njoftuar policinë. Është friësuar edhe për vete se mos ndoshta kanë hyrë edhe në shtëpinë e tij dhe instiktivisht ka marrë një thikë dhe ka filluar të kontrollonte shtëpinë. Pas 8–10 minutash përsëri ka thirrur policinë dhe pasi kanë ardhur, ai u ka sinjalizuar se ku gjendet sepse polica i ka thanë se janë afër por nuk e dinë ku është shtëpia. Largësia prej shtëpisë deri në “A. 2” është përafërsisht 300 – 400 metra, dhe këmbë mund të arrihet për 3 – 5 minuta, aty afër është edhe pompa “S. P.” e cila ka edhe restorantin.

Dëshmitari I. E. ka dëshmuar se prej vitit 1992 punon si taksi vozitës, nuk i kujtohet data e saktë, diku në fillim të vitit 2017, në ora 09:00 – 10:00 ka qenë në parking ku rinë gjithmonë, përballë stacionit të autobusave në Suharekë me veturën “BMW 530”, ngjyrë të zezë, kur kanë ardhur tre persona të moshës së tij apo pak më të ri dhe kanë pyetur sa para duhet për t’i dërguar deri në Prizren, ka treguar tarifën, nuk i kujtohet a ka thënë 13 apo 15 €, ata janë pajtuar dhe janë nisur në drejtim të Prizrenit ku diku në rrugën e tranzitit të ri e kanë pyetur sa para kërkon që t’i dërgojë deri në Gjakovë dhe janë marr vesh për 20 €, asht që i ka dërguar në Gjakovë. Të nesërmen diku në ora 09:00 apo 10:00, derisa ka qenë i parkuar te stacioni i autobusave në Suharekë ka ardhur policia e krimeve, e kanë pyetur se mos e ka emrin Ilir dhe pasi ka pohuar, e kanë pyetur ku ka qenë ditën e djeshme, ai është përgjigjur se ka qenë në Prizren edhe në Gjakovë, po ashtu e kanë pyetur nëse i njeh persona të cilat i ka transportuar, përgjigja e tij ka qenë negative dhe pastaj policia ia tregoi fotografën e veturës së tij. Gjatë vozitjes në Prizren i kujtohet se dy persona kanë zbritur prej veturës diku te rrethi i tranzitit të ri, ndërsa i treti ka kërkuar ta dërgonte në shtëpinë e vet në rrugën e tranzitit nga ana e djathtë ku ka qenë një shtëpi e re një apo dy katëshe, ka hyrë brenda dhe pas dy tre minutash është kthyer dhe se së bashku kanë shkuar deri te vendi ku kanë zbritur

ata dy persona. Gjatë deklarimit, me kërkesën për identifikim të personave në sallën e gjykimit, dëshmitarit kthehet në drejtim të të akuzuarve dhe me dorë tregon në të akuzuarin A. M. duke sqaruar se ky person ka qenë i ulur në ulësen e prapme por nuk i kujtohet në cilën anë, duke shikuar në drejtim të të akuzuarëve D. B. dhe R. S. deklararon se nuk i kujtohet a kanë qenë ata në veturën e tij. Gjatë dhëniës së deklaratës në polici, policia i ka treguar fotografitë e personave që sot ka identifikuar dhe një person tjetër i cili ka qenë në veturë dhe emrat e tyre.

Dëshmitari N. M. ka dëshmuar se prej vitit 2016 punon në kompani “P.”, vendi i punës është të QT “A. +” e cila gjendet tek spitali regjional. Punon vetëm në ndërimin e natës prej orës 22:00 deri më 07:00. I kujtohet se në polici ka dhënë një deklaratë lidhur me një veturë e cila ka qenë i parkuar brenda në parkingun e “A. +”. Zakonisht kur përfundon orari i punës të Qendrës tregtare mbyllet hyrja në parking me zinxhir në anën e pompës së benzinës “S. P.” ashtu që veturat dalin vetëm nga dalja e kundërt që gjendet në anën e spitalit dhe kur largohen të gjithë veturat vendoset zinxhiri dhe mbyllet parkingu. Natën kritike derisa ka qenë në kabinë ka vërejtur një veturë duke u afruar daljes nga parkingu, zinxhiri ka qenë i vendosur prandaj ka dalë prej kabinës për të hapur zinxhirin dhe të lirojë daljen e veturës, një person nga vetura i ka thënë “na hap derën “ i ka treguar çelësin dhe ka shkuar për ta heq zinxhirin e mbyllur me dry. Nuk ka vërejtur se sa persona kanë qenë sepse vetura ka qenë larg 50 m, afër autolarjes dhe nuk ka vërejtur nga cili drejtim kanë ardhur personat dhe çfarë tipi i veturës ka qenë, por i kutohet se kjo ka ndodhur diku kah ora 04:00 mëngjesit.

Gjykata ka besuar pjesës thelbësore të deklaratave të dëshmitarëve të cilat janë të rëndësishme për marrjen e aktgjykimit, sepse deklaratat e tyre vërtetohen me provat materiale që kanë të bëjnë me ngjarjen e natës kritike në shtëpinë e të dëmtuarve, si dhe ngjarjeve para dhe pas kryerjes së veprës, e po ashtu vërtetohen edhe me deklaratat e të akuzuarve R. S. dhe D. B..

Gjykata nuk ka besuar deklaratës se të akuzuarit R. Th. se i njëjti pasi është takuar me të akuzuarit R. S. dhe A. M. në restorantin “S. P.”, ka shkuar në Suharekë për ta takuar të dashurën e tij dhe bashkë kanë vazhduar deri në Ferizaj për tu furnizuar me narkotikë dhe se në kthim ka shkuar në restorantin e vet “A. C.”. Kjo sepse mbrojtja e tij është në kundërshtim me vetëveten dhe me deklaratat e të akuzuarve të tjerë R. S., A. M. dhe D. B. si dhe me provat materiale si hartografia e vendodhjes së tij. Po ashtu gjykata nuk ka besuar mbrojtjes së të akuzuarit R. S. se i njëjti ka ardhur në Prizren për tu furnizuar me substancë narkotike e kjo për arsye se mbrojtja e këtillë është në kundërshtim me vetveten meqenëse në momentin tjetër deklaroi se kohëve të fundit automjetin e vet “Renault Twingo” ia ka dhënë një personi nga Shqipëria, i cili merret me bari, ashtu që parashtrrohet pyetja se a kishte mundësi R. S. që të furnizohet me narkotikë mu nga ky person nga Shqipëria e jo vetëm prej të akuzuarit R. Th.. Nuk pranohet as pjesa e mbrojtjes së tij se ai nuk ka dashur të hynte në shtëpinë e të dëmtuarëve dhe se i akuzuari R. Th. i ka sugjeruar që të qëndronte jashtë tek vendi ku parkohen bagerat ku ka pritur një orë. Kjo pjesë e mbrojtjes është në kundërshtim me deklaraten e të akuzuarit D. B., i cili në të njëjtën mënyrë dhe duke dashur ta zvoglojë përgjegjësinë, ka deklaruar se në shtëpinë e të dëmtuarve kanë hyrë të akuzuarit R. S., R. Th. dhe A. M. ndërsa ai ka pritur jashtë. Po ashtu mbrojtja e këtillë është në kundërshtim edhe me deklaratat e të dëmtuarëve të cilit kanë deklaruar se në shtëpinë e tyre kanë parë 4 – 5 persona e jo më pak.

Gjykata nuk ka mund të pranonte as deklaraten e të akuzuarit A. M. në atë pjesë se derisa pinin kafë në restorantin “S. P.”, ka dëgjuar R. Th. dhe R. S. duke biseduar dhe

përmendur narkotikë, në të cilin moment prej R. S. ka kërkuar që ta dërgonte deri te pompa e benzinës “H. P.” me qëllim që të shkonte në shtëpi dhe se R. S. është pajtuar për ta dërguar atje. Kjo pjesë e mbrojtjes është në kundërshtim me vetveten sepse në momentin tjetër ai deklaroi se pasi është takuar me R. S. diku në qytet rreth ora 19:00 - 20:00, gjatë vozitjes në drejtim të restorantit “S. P.”, ky i fundit ka thënë se atje do të takohen me R. Th. prej të cilit do të sigurohet me narkotikë. Kjo na shpie në konkluzion se mbrojtja e këtij të akuzuari është jo logjike, e vetmuar, e pa mbështetur në provat e administruara dhe në kundërshtim me ato prova, siç është hartografia e cila tregon vendndodhjen e të akuzuarit A. në momentin e incidentit pranë shtëpisë së të dëmtuarit, prandaj shtrohet pyetja pse A. M. bashkë me Reshat Sellaj ka shkuar në restorant “S. P.” meqë rrugës R. i ka treguar për qëllimin e shkuarjes atje dhe për takimin me R. Th.. Pos kësaj kjo deklaratë është në kundërshtim edhe me deklaratën e R. S..

Gjykata po ashtu nuk ka besuar deklaratës së të akuzuarit D. B. në atë pjesë kur ai ka deklaruar se nuk ka dashur të hynte në shtëpinë e të dëmtuarëve dhe ka mbetur jashtë për të bërë roje. Mbrojtja e këtyre është në kundërshtim me deklaratën e të akuzuarit R. S. si dhe me deklaratat e të dëmtuarëve, të cilit siq u cekë më lartë, kanë deklaruar se kanë parë në dhomë 4 -5 persona.

Gjykata ka analizuar edhe deklaratat e të akuzuarve të dhëna në shqyrtimin kryesor, ku në tërësi i kanë ndryshuar duke mohuar se natën kritike kanë qenë në restorantin “S. P.” dhe kanë theksuar se në fakt kanë qenë në restorantin “A. C.” ku kanë mbetur deri në ora 22:30 minuta, kur i akuzuari R. Th., me automjetin e tij i ka dërguar deri te pompa “H. P.”, nga automjeti kanë dalë A. M. dhe D. B. ndërsa R. Th. dhe R. S. janë kthyer në restorantin “A. C.”, ku ky i fundit e ka marrë automjetin e tij të parkuar aty më herët dhe ka shkuar në shtëpi ndërsa i akuzuari R. Th., së pari ka shkuar deri te restoranti D. Zh., pastaj deri në Suharekë, ka vazhduar në Ferizaj dhe është kthyer në restorantin e vet, si dhe se te restoranti i R. Th. kanë shkuar me qëllim që të furnizohen me narkotikë. Sipas mendimit të Gjykatës këto deklarata të dhëna në shqyrtimin gjyqësor në fakt janë të montuara, për arsye se gjatë procedurës të akuzuarit kanë pasur mundësi që të informohen mbi rezultatet e tërë procesit që lidhet me ngjarjen si dhe të kuptojnë se në çfarë mënyrë janë mbrojtur të bashkakuzuarit, me ç rast kanë mohuar pjesët e rëndësishme të deklaratave nga procedura paraprake duke e ndërthurr një strategji sipas së cilës verzionet e veta i kanë drejtuar në lëvizjet e tyre në realcion Prizren – restoranti “A. C.” - shkuarja e sërishme nëpër shtëpitë e tyre. Pranë kësaj secili në mënyrë të veçantë ka cekur arsyet pse kanë dhënë deklarata të ndryshme. I akuzuari R. Th. si arsye ka cekur se atë ditë dhe atë mbrëmje vazhdimisht ka qenë nën ndikim të narkotikut dhe nuk ka qenë fare i vetëdijshëm për veprimet e veta; i akuzuari R. S. si arsye ka deklaruar në të njëjtën mënyrë siç ka qenë e shkruar në letrën të cilën e ka dërguar D. B. përmes një të paraburgosuri i cili ato ditë ishte transferuar nga Burgu i Dubravës në Burgun e Prizrenit, në të cilën letër D. ka sugjeruar në çfarë mënyrë duhet të deklarohet duke i thënë se do të jetë shumë më mirë për te nëse deklaroi në atë mënyrë, mirëpo më vonë ka kuptuar se në fakt ka qenë i mashtruar; arsyeja e të akuzuarit A. M. për ndryshimin e deklaratës ka qenë se gjatë dhënies së deklaratës në procedurën paraprake ka qenë gabimisht i kuptuar, sepse kur ka thënë se është takuar në qytet me R. S., në fakt ka menduar në Suharekë, ndërsa kur ka thënë restorant, ka menduar në “A. C.” dhe në qoftë se restoranti i R. Th. thirret “S. P.” atëherë ka qenë atje; i akuzuari D. B. si arsye për ndryshimin e deklaratës ka përmendur se nga ai kanë kërkuar që ta pranonte kryerjen e veprës dhe se një zyrtar policor e ka vizituar në Dubravë duke ia prezentuar të gjitha rastet për të cilat dyshohet se i ka kryer, kanë qenë në pyetje rreth njëzet raste dhe i është premtuar se mund të marrë një dënim prej 1,5 deri 2 vite nëse pranon kryerjen e kësaj vepre, e në të kundërtën do të dënohet deri në 10 vjet. Gjykata

nuk ka pranuar arsyet e këtyre të akuzuarve sepse ato janë jo logjike, jo të bindëshme dhe nuk mbështeten në asnjë provë të cilat gjykata ka pasur në dispozicion, po në fakt ato janë harmonizuar me qëllim që t'i shmangen përgjegjësisë penale juridike.

Gjykata nuk ka mund t'i pranonte tezat e mbrojtjeve e të akuzuarve me të cilat kanë mohuar të dhënat nga akuzat, me të cilat kanë potencuar se me asnjë nga provat e administruara nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën ngarkohen, pranë kësaj duke u thirrur në besueshmërinë e provave si dhe në të vërtetën e deklaratave të dëmtuarëve dhe dëshmitarëve. Kjo për arsye se, sipas mendimit të gjykatës tezat e tyre janë bazuar në mohimin mekanikë të besueshmërisë dhe saktësisë së provave, pa cekur argumente në të cilat do t'i bazonin ato teza të mbrojtjeve.

Pra, nga deklaratimet mbi rrjedhjes së ngjarjes, në rend të parë ato që i shërbejnë mohimit të arsyetuar të provave nga akuzat, gjykata i nxjerr ato prova që lidhen me raportin psikik të të akuzuarve, të veprimeve të tyre dhe të pasojës dhe nxjerr konkluzion se të akuzuarit kanë vepruar me dashje, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme me përdorimin e forcës dhe kanosjes serioze. Duke analizuar rastin konkret gjykata konsideron se nga ana e të akuzuarve është përdorur forca dhe kanosja serioze ndaj të dëmtuarve në atë mënyrë që natën kritike të dy të dëmtuarit kanë qenë të sulmuar fizikisht, kanë qenë nën kërcënime serioze me thikë dhe kaqavidë, e nga ana e njerit prej tyre edhe me pistoletë, duke qenë në aso situatë kur nuk kanë qenë në gjendje të rrezistojnë në asnjë mënyrë dhe meqenëse jeta e tyre ishte në rrezik, i dëmtuari ka dorëzuar çelësat e kasafortës nga e cila kanë marrë të gjithë ato çka kishte brenda dhe prenë e kanë vendosur në një çarçafë dhe kanë ikur nga vendi i ngjarjes.

Se të akuzuarit janë organizuar si grup për të realizuar qëllimet e tyre në kryerjen e veprës penale, vërtetohet nga rrethanat se ditën kritike katër persona të cilit jetojnë në vende të ndryshme, në orët e pasditës takohen në qytet në të njëjtin vend dhe kohë, pastaj përsëri takohen në vendin e caktuar, konkretisht në restorantin “S. P.” i cili gjendet shumë afër lagjes ku të dëmtuarit kanë shtëpinë, e gjoja me një qëllim që të funizohen me narkotik prej të akuzuarit R. Th., pastaj parkojnë automjetin diku në skaj të parkingut e QT “A. 2” larg syve të rojes e afër daljes nga parkungu, bëjnë xhiro rreth e rrotul lagjes dhe në një kohë të volitshme, në orët e vona, kur të gjithë janë në gjymë, hyjnë në shtëpi dhe kryejnë veprën. Po ashtu jo rastësisht ata paraprakisht janë marrë veshë që të takohen edhe ditën e nesërme por jo që të funziohen me narkotikë, siç janë mbrojtur, por në fakt, sipas mendimit të gjykatës, atë takim kanë planifikuar për shkak të ndarjes së presë. Kjo vërtetohet edhe me kontaktet e shumta telefonike në mes tyre si para ashtu edhe pas rastit, e ky fakt është vërtetuar nga raporti i hyrje- daljeve dhe hartografia.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve formohen elementet e veprës penale si në shqiptim të aktgjykimit, për të cilën vepër penale i ka shpallur fajtorë dhe gjykuar sipas ligjit.

Në rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoi të gjithë rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KP, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit dhe me vlerësimin e të gjitha rrethanave rënduese dhe lehtësuese gjykata ka pasur parasysh se secila prej këtyre rrethanave veç e veç janë vlerësuar në ndërlidhje me të gjitha rrethanat të tjera të cilat ndikojnë në matjen e dënimit, në rastin konkret duke gjetur si rrethana rënduese shkallën e rrezikut shoqëror të veprës, shkallën të rrezikimit e vlerës së mbrojtjes – shikuar përmes peshës së veprës së kryer dhe

mënyrës së kryerjes së veprës, duke pasur parasysh edhe pasojat konkrete se me përdorimin e dhunës fizike dhe kërcënimit ndaj të dëmtuarve, personave në moshë në orët e vona të natës, të cilit fare nuk kanë pritr se mund t'ju ndodhë diç e tillë, se të akuzuarit janë të njohur si kryers të veprave penale të natyrave të ndryshme dhe të kësaj natyre, këtu marrë parasysh se i akuzuari D. B. vetëm pesë ditë më parë sapo ka dalë nga vuajtja e dënimit, se me sjelljen e tyre kanë treguar mospënim duke mohuar kryerjen e veprës me qëllim që t'i largohen përgjegjësisë penale. Andaj duke mos gjetur rrethana lehtësuese në anën e të akuzuarve gjykata i ka denuar si në dispozitiv të aktakuzës duke konsideron se edhe me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit.

Comment [VZ1]:

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në shqiptimin e aktgjykimit.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marrë në bazë të nenit 463 KPP.
Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 450 KPP.

Vendimi mbi vazhdimin e paraburgimit është marrë në bazë të nenit 367 par.2 lidhur me par.1 pika 1.1 KPP.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për Krime të Rënda
P.nr. 17/17, dt. 30.03.2018

Sekretarja juridike
Valdete Zurnaxhiu

Përkthyesja
Asnije Berisha

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtarja
Raima Elezi

UDËZIME JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë në ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.